



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 94

7 gusht

2012

P Ë R M B A J T J A

| | | Faqe |
|--|---|------|
| Rezolutë e Kuvendit datë 12.7. 2012 | Për vlerësimin e punës së komisionerit për mbrojtjen nga diskriminimi për vitin 2011..... | 5143 |
| Rezolutë e Kuvendit datë 12.7. 2012 | Për vlerësimin e veprimtarisë së komisionit të shërbimit civil për vitin 2011..... | 5144 |
| Dekret nr. 7601 datë 10.7.2012 | Për dhënie të shtetësisë shqiptare | 5145 |
| Dekret nr. 7626 datë 11.7.2012 | Për dhënie të shtetësisë shqiptare | 5146 |
| Dekret nr.7656 datë 13.7.2012 | Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare | 5147 |
| Dekret nr. 7707 datë 19.7.2012 | Për dhënie të shtetësisë shqiptare | 5147 |
| Vendim i GJK nr.41, datë 19.7.2012 | Me objekt: 1. Shfuqizimi i vendimit nr.106, datë 23.6.2011 i Kuvendit të Shqipërisë. 2.Zgjidhja e konfliktit të kompetencës ndërmjet institucionit të Presidentit të Republikës dhe atij të Kuvendit të Shqipërisë..... | 5148 |

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E PUNËS SË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI PËR VITIN 2011

Kuvendi i Shqipërisë:

- Duke konsideruar mbrojtjen e së drejtës së çdo personi për barazi para ligjit, parimin e barazisë dhe trajtimit për shanse dhe mundësi të barabarta, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminim, si përparësi kyçe të Qeverisë Shqiptare drejt progresit të shtetit shqiptar;

- Duke inkurajuar përmirësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një institucion i pavarur, i cili garanton mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin;

- Duke shprehur vullnetin e tij për të nxitur veprimtarinë e Komisionerit në drejtim të përmirësimit të legjislacionit vendas, sipas frymës së standardeve ndërkombëtare, për të synuar qasje efikase dhe të harmonizuara në luftën për mbrojtjen kundër diskriminimit dhe sundimin e parimit të trajtimit të barabartë, bazuar në një listë joshteruese arsyeshe të përcaktuara në dispozitat kushtetuese dhe ligjore;

Vlerëson:

- Fillimet pozitive të veprimtarisë së këtij institucioni në vitin e parë të plotë të veprimtarisë së tij;

- Përpjekjet për vendosjen e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të veprimtarisë së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me organet shtetërore, si dhe me institucionet joqeveritare e organizmat ndërkombëtarë, që kontribuojnë në çështjen e mosdiskriminimit;

- Hartimin dhe miratimin e instrumenteve të rëndësishme strategjike dhe objektivave specifike të domosdoshëm për zbatimin e ligjit dhe monitorimin e tij në vijim;

- Përpjekjet e Komisionerit gjatë ushtrimit të kompetencave për të rritur imazhin e tij profesional dhe për të konsoliduar rolin dhe autoritetin e tij në publik.

Konstaton se:

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjatë vitit 2011 ka prezantuar, bazuar në të dhëna ndërkombëtare dhe të shoqërisë civile, një statistikë përgjithësuese të fenomenologjisë dhe tipologjisë së çështjeve aktuale të diskriminimit, si dhe analizime të çështjeve për kategori të veçanta të shoqërisë shqiptare;

- Ka synuar zgjerimin e veprimtarisë së tij në drejtim të njohjes institucionale në publik dhe rritjes së ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit së tij lidhur me mbrojtjen kundër diskriminimit në Shqipëri;

- Ka finalizuar dokumentin strategjik dhe planin e veprimit afatmesëm 2012-2015 të veprimtarisë së tij institucionale;

- Ka realizuar vrojtje në fushën e arsimit dhe ka rekomanduar disa masa rregulluese bazuar në gjetjet e tij;

- Ka trajtuar një numër ankesash sipas kompetencave ligjore;

- Ka qenë aktiv në ofrimin dhe mbështetjen e nismave të ndryshme legjislative, duke propozuar rekomandime ligjore;

- Ka përfaqësuar institucionin rregullisht në konferenca ndërkombëtare dhe ka synuar përfshirjen konkrete në to;

- Ka pasur mbështetjen dhe asistencën e vazhdueshme profesionale të organizmave ndërkombëtarë që kanë objekt mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe që kontribuojnë në këtë fushë.

Kuvendi kërkon nga KMD-ja për vitin 2012:

- Forcimin e angazhimit për të monitoruar zbatimin me korrektësi të ligjit nga të gjitha institucionet e ngarkuara për zbatimin e ligjit;

- Ndjekjen e vazhdueshme të objektivave strategjike, sipas planit të veprimit dhe kontrollin e rreptë të zbatimit të tyre;



- Rritjen e numrit të shqyrtimit të ankesave me objekte të ndryshme të çështjeve të pabarazisë, duke i dhënë përparësi trajtimit kryesisht të tyre;
- Përbushjen e të gjitha kompetencave ligjore, duke konsideruar institucionin që përfaqëson jo vetëm këshillues por edhe ndëshkues;
- Identifikimin e nevojave për amendime ligjore dhe përmirësim të mëtejshëm të mekanizmave ligjorë;
- Forcimin e koordinimit me strukturat e tjera paralele dhe qartësimin e pozicionit të saj ligjor për sa u përket kompetencave dhe juridiksionit;
- Rritjen e pranisë së KMD-së në median e shkruar dhe vizive, me qëllim nxitjen e qytetarëve për të kërkuar mbrojtjen e të drejtave të tyre, krijimin e besimit të publikut tek institucioni, rritjen e ndërgjegjësimit në nivel lokal dhe në sektorin privat;
- Vendosjen e forcimit të bashkëpunimit me gjyqësorin në vazhdimësi;
- Zgjerimin e bashkëpunimit me organe të ndryshme publike, aktorë të shoqërisë civile, organizata ndërkombëtare, përfshirë rrjetin *Equinet*, si dhe vendosjen e bashkëpunimit me institucione homologe;
- Publikimin e raporteve periodike për gjendjen në fushën e antidiskriminimit në vend;
- Thellimin e bashkëpunimit me shoqatat që përfaqësojnë komunitetet rome dhe egjiptiane, personat me aftësi të kufizuara, LGBT-të, si dhe grupe të tjera në nevojë;
- Rritjen e profesionalizmit dhe efikasitetit të punës të stafit të Zyrës së Komisionerit për një trajtim efektiv, cilësor dhe në kohë të ankesave.

12 korrik 2012

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË SHËRBIMIT CIVIL PËR VITIN 2011

Kuvendi i Shqipërisë,

- Duke konsideruar reformën e administratës publike si një nga përparësitë dhe kriteret kryesore për anëtarësimin e Shqipërisë në BE;
- Duke qenë i gatshëm për të mbështetur përmirësimin e kuadrit ligjor dhe zbatimin e duhur të ligjit, si dhe ngritjen e kapaciteteve për një shërbim civil dhe administratë publike të qëndrueshme, profesionale dhe të bazuar në meritë;
- Në vijimësi ka njohur rolin e Komisionit të Shërbimit Civil si institucion i pavarur për mbikëqyrjen dhe menaxhimin e shërbimit civil në nivel qendror e vendor;
- Me insistim ka kërkuar që KSHC-ja të jetë promotor i zhvillimit të reformave në administratën publike.

Konstaton se KSHC-ja për vitin 2011:

- Ka përmirësim të veprimtarisë në drejtim të metodologjisë së raportimit në aspektin analizues të problematikave dhe trajtimit të parimeve thelbësore, mbi të cilat është ndërtuar ligji dhe sipas të cilit duhet të funksionojë shërbimi civil;
- Ka përbushur objektivat ligjorë në trajtimin dhe zgjidhjen e të gjitha ankesave brenda afatit ligjor;
- Ka realizuar mbikëqyrjen e administrimit të shërbimit civil në nivele të ndryshme institucionale dhe ka vijuar me ndjekjen e zbatueshmërisë së rekomandimeve të lëna prej tij;
- Ka bërë përpjekje për të përmirësuar situatën e përgjithshme të menaxhimit të shërbimit civil në tërësi dhe në veçanti në institucionet e pushtetit vendor;

- Ka çuar në gjykatë, në cilësinë e palës procedurale, institucione qendrore që nuk kanë zbatuar vendimet e KSHC-së;
- Ka zhvilluar faqen zyrtare dhe ka publikuar në mënyrë të përditësuar çdo informacion të nevojshëm për ankuuesit dhe institucionet;
- Ka vijuar me trajnime dhe seminare me programe trajnimi, sipas nevojës dhe mangësive të konstatuara gjatë kontrollit nëpër institucione;
- Ka tregues të përmirësimit të zbatimit të instituteve të ndryshme të shërbimit civil, si pasojë e akteve nënligjore të nxjerra për zbatim, dhe punës së institucioneve zbatuese të legjisllacionit të shërbimit civil.

Kuvendi kërkon nga KSHC-ja për vitin 2012:

- Zbatimin e detyrave të adresuara në planin e veprimit, me qëllim përmirësimin e elementeve të rëndësishme të shërbimit civil në administratën publike;
- Rritjen e efikasitetit institucionale në drejtim të mbikëqyrjes në të gjitha nivelet e administratës publike;
- Ndjekjen me rigorozitet të rekomandimeve dhe zbatueshmërinë e vendimeve të KSHC-së nga institucionet;
- Reformimin dhe përgatitjen institucionale, në përshtatje me ligjin e ri për shërbimin civil;
- Vijimin e trajnimeve me nivele nëpunësish dhe institucionale, me qëllim garantimin e një menaxhimi më efikas të shërbimit civil nga ana e tyre;
- Koordinimin dhe mbështetjen më produktive me organet e tjera zbatuese të legjisllacionit të shërbimit civil.

12 korrik 2012

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

DEKRET
Nr. 7601, datë 10.7.2012

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, të neneve 20 dhe 24 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|------------------------------|-----------------------------|
| 1. Kostandina Andon Kostiku | 8. Ida Isak Jakupi |
| 2. Ols Viron Cinxo | 9. Aldo Isak Jakupi |
| 3. Gerd Viron Cinxo | 10. Barjam Mahmut Jakupi |
| 4. Fatbardh Durro Deliallisi | 11. Pranvera Sali Dibra |
| 5. Mahmut Mustafa Jakupi | 12. Vangjel Sava Kostandini |
| 6. Isak Mahmut Jakupi | 13. Igli Ismet Sanxhaku |
| 7. Admirim Isak Jakupi | 14. Aurika Nasi Dhimitri |



15. Niko Vasil Ormova
16. Engjellushe Sherif Xhoja
17. Altin Vasil Tarusha

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr. 7626, datë 11.7.2012

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 pika 7 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar në propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Suada Samir Jashari
2. Xhemile Ismet Berisha
3. Cyme Hasan Lulaj
4. Nora Salih Selmani
5. Fitore Sadik Govori
6. Krenar Mehmet Ramadani
7. Liridon Ekrem Latifi
8. Amir Izeir Bilali

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET

Nr. 7656, datë 13.7.2012

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë të Brendshme

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|---------------------------------|---------------------------------|
| 1. Gjergji Todi Dema | 9. Dhimitraq Llazo Elmazi |
| 2. Enkeleida Ymer Çelaj (Muhja) | 10. Frank Nazmi Limani |
| 3. Sara Edmond Çelaj | 11. Artemida Veli Lenz (Islami) |
| 4. Klea Edmond Çelaj | 12. Artan Baftjar Çenga (Cenga) |
| 5. Arian Azem Gaxha | 13. Benito Çelo Malaj |
| 6. Gentian Fatos Çallëku | 14. Erjola Haki Laçe (Muço) |
| 7. Albana Petrit Demir (Kukli) | 15. Ridana Muharem Kacanja |
| 8. Alban Muhamet Tirana | 16. Fjorda Ilir Kalleshi |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET

Nr. 7707, datë 19.7.2012

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" dhe 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 pika 7 dhe nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Edi Muhamed Shukriu
2. Erleta Ukshin Hoti

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi



VENDIM
Nr. 41, datë 19.7.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

| | | | |
|-------------------|--------------------------------|---|---|
| Bashkim Dedja | Kryetar i Gjykatës Kushtetuese | | |
| Vladimir Kristo | Anëtar i | “ | “ |
| Xhezair Zaganjori | Anëtar i | “ | “ |
| Petril Piloçi | Anëtar i | “ | “ |
| Vitore Tusha | Anëtare e | “ | “ |
| Sokol Berberi | Anëtar i | “ | “ |
| Admir Thanza | Anëtar i | “ | “ |
| Altina Xhoxhaj | Anëtare e | “ | “ |
| Fatmir Hoxha | Anëtar i | “ | “ |

me sekretare Edmira Babaj, në datën 16.2.2012 dhe 29.2.2012, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen me nr. 2 Akti, që i përket:

KËRKUES: Presidenti i Republikës, përfaqësuar me autorizim nga Artur Metani.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Shqipërisë, përfaqësuar me autorizim nga Lulzim Lelçaj dhe Arjeta Cefa.

OBJEKTI: 1. Shfuqizimi i vendimit nr. 106, datë 23.6.2011 i Kuvendit të Shqipërisë.

2. Zgjidhja e konfliktit të kompetencës ndërmjet institucionit të Presidentit të Republikës dhe atij të Kuvendit të Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 124/1, 131/ç, dhe 134/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Fatmir Hoxha, përfaqësuesin e kërkuarit, Artur Metani, që kërkoi pranimin e kërkesës, përfaqësuesit e subjektit të interesuar, Lulzim Lelçaj dhe Arjeta Cefa, që kërkuan rrëzimin e saj dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) në datat 28.4.2010 dhe 24.5.2010 ka deklaruar përfundimin e mandatit të katër gjyqtarëve të saj, konkretisht të gjyqtarëve: S.Sadushi, P.Piloçi, Xh.Zaganjori dhe A.Thanza. Këto vendime i janë dërguar Presidentit të Republikës (Presidentit) për fillimin e procedurave të nevojshme për përtëritjen e përbërjes së kësaj Gjykate.

2. Presidenti, bazuar në nenin 125/1 të Kushtetutës, në datë 6.9.2010, ka dërguar në Kuvendin e Shqipërisë (Kuvendi) katër dekrete për emërim të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Gjatë shqyrtimit të këtyre dekreteve në Kuvend, konkretisht në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, një grup deputetësh vendosën dërgimin e një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për interpretimin e nenit 125, pika 1 dhe 3 të Kushtetutës lidhur me procedurën e përtëritjes së përbërjes së Gjykatës Kushtetuese.

3. Gjykata, me vendimin nr. 24, datë 9.6.2011 (nr. 24/2011), mbajti qëndrimin se *“Presidenti dhe Kuvendi, gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre kushtetuese janë interpretuesit e parë të normës kushtetuese dhe përcaktimi nga ana e Gjykatës i kritereve që duhet të plotësojë një kandidaturë çon në marrjen nga kjo e fundit të kompetencës kushtetuese të secilit prej këtyre organeve. Në këtë kuptim, Presidenti dhe Kuvendi, bazuar në parimin e luajalitetit kushtetues, duhet të bashkëpunojnë për*

përcaktimin e kriterëve ligjore, në përputhje me kërkesën kushtetuese për kualifikim të lartë, në funksion të sigurimit të një përbërjeje cilësore të Gjykatës Kushtetuese”. Gjithashtu, Gjykata ka rikonfirmuar se “pëlqimi që kërkojnë normat kushtetuese nënkupton një lloj konsensusi midis dy organeve kushtetuese që përfaqësohen në procesin e emërimit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë. Pjesëmarrja e Kuvendit në këtë proces ka për qëllim balancimin e kompetencës së Presidentit në emërimin e gjyqtarëve dhe kjo vjen në harmoni edhe me parimin e ndarjes dhe të balancimit ndërmjet pushteteve, të parashikuar në nenin 7 të Kushtetutës. Në këtë vështrim, pjesëmarrja e Kuvendit në procesin e emërimit të gjyqtarëve, që shkon tej një kontrolli juridik të procesit, është në harmoni të plotë me natyrën politike të këtij organi ... respektimi dhe zbatimi i parashikimit kushtetues të përtëritjes së përbërjes së saj çdo tre vjet me një të tretën e anëtarësisë paraqet rëndësi të veçantë në kuptim të ruajtjes dhe forcimit të pavarësisë dhe vazhdimësisë së këtij organi ... është në kompetencë të ligjvënësit kushtetues që të gjejë dhe të zbatojë mekanizmin e përshtatshëm për të respektuar parimin kushtetues të përtëritjes së përbërjes së Gjykatës Kushtetuese çdo tre vjet me një të tretën e saj”.

4. Pas shpalljes së këtij vendimi të Gjykatës, Kuvendi, me vendimin e tij nr. 106, datë 23.6.2011 (nr. 106/2011) “Për miratimin e propozimit të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, për zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 24/2011 për ripërtëritjen e përbërjes së Gjykatës Kushtetuese çdo tre vjet me një të tretën e saj”, vendosi mosshqyrtimin e mëtejshëm të dekreteve të Presidentit të Republikës për emërim të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese deri në prill të vitit 2013, pasi, sipas këtij Komisioni, në këtë Gjykatë nuk ka vende vakante për t’u plotësuar.

5. Presidenti, në datë 28.7.2011, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Presidencës, iu drejtua me shkresë Kuvendit, ku shpjegonte se pezullimi i shqyrtimit të dekreteve të tij për emërimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese nuk është në përputhje as me dispozitat kushtetuese për emërimin dhe organizimin e përbërjes së Gjykatës dhe as me vendimin nr. 24/2011 të saj. Për këtë arsye, Kuvendi duhej të vazhdonte me shqyrtimin e dekreteve duke i miratuar ose rrëzuar ato në seancë plenare dhe jo në Komision. Nga ana tjetër, Kuvendi, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm, me shkresën e datës 8.8.2011, i është përgjigjur Presidentit duke konfirmuar edhe një herë qëndrimin e tij se çështja e emërimit të tre anëtarëve të rinj të Gjykatës Kushtetuese është çështje e mbyllur deri në prill të 2013, kohë në të cilën duhet të zhvillohet përtëritja e radhës. Sipas tij, referuar vendimit nr. 24/2011 të kësaj Gjykate, nuk ka vende vakante në përbërjen e saj, pasi përtëritja e fundit është realizuar në vitin 2010.

6. **Kërkuesi**, Presidenti, pretendon se me anë të vendimit nr. 106/2011 të Kuvendit, atij i është cenuar kompetenca për emërimin e anëtarëve të Gjykatës parashikuar nga neni 125/1 i Kushtetutës dhe për këtë arsye ky vendim duhet të shfuqizohet si antikushtetues. Kërkuesi paraqet këto argumente për antikushtetueshmërinë e këtij vendimi:

6.1. Kuvendi ka bllokuar procedurat kushtetuese për shqyrtimin e dekreteve për emërim të anëtarëve të rinj të Gjykatës me një akt të brendshëm dhe jashtë kompetencave të tij. Kuvendi nuk mund të zgjasë mandatin e anëtarëve të organeve kushtetuese me vendim të brendshëm të tij, pasi mandati i tyre parashikohet nga Kushtetuta. Mandati kushtetues mund të ndryshohet vetëm me ligj kushtetues dhe jo me vendim të Kuvendit. Kuvendi nuk mund të kthejë me vendim dekretet e Presidentit pa i shqyrtuar ato më parë dhe pa i votuar ato në seancë. E vetmja mundësi për Kuvendin është rrëzimi ose miratimi i dekreteve të Presidentit dhe jo kthimi pa veprim i tyre.

6.2 Kuvendi, me vendimin e tij, ka zëvendësuar Gjykatën Kushtetuese duke interpretuar ndryshe normën kushtetuese dhe, si rrjedhojë, duke nxjerrë një përfundim të ndryshëm nga ai i shprehur në vendimin nr. 24/2011 të saj.

6.3 Kuvendi, ndryshe nga sa përcakton Gjykata në vendimin e saj nr. 24/2011, nuk ka gjetur mekanizmin e duhur kushtetues për të realizuar përtëritjen e saj me një të tretën çdo tre vjet. Pezullimi i shqyrtimit të dekreteve nuk është zgjidhja e duhur kushtetuese për situatën në të cilën ndodhet përbërja e kësaj Gjykate.

6.4 Kuvendi, duke mos realizuar zëvendësimin e tre anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese ka cenuar edhe nenin 125/2 të Kushtetutës, i cili përcakton se mandati i gjyqtarëve kushtetues është 9 vjet. Vendimi i Kuvendit objekt kërkese ka krijuar konflikt kompetencash duke mos lejuar zëvendësimin e gjyqtarëve kushtetues, si dhe ka vënë në dyshim legjitimitetin e Gjykatës Kushtetuese sa i takon vazhdimin të



qëndrimit në detyrë të anëtarëve që u ka mbaruar mandati.

7. **Subjekti i interesuar**, Kuvendi, paraqiti këto argumente lidhur me kërkesën e Presidentit:

7.1 Kërkuesi nuk legjitimohet në kërkimet e tij, pasi objekti i kërkesës është i paqartë dhe i paplotë. Kërkuesi nuk ka parashtruar qartë se cila kompetencë i është marrë atij dhe në çfarë mënyre është penguar ai për të ushtruar kompetencën e tij. Kuvendi nuk ka marrë në asnjë rast prerogativat e Presidentit, pasi ai nuk ka emëruar asnjë kandidat për anëtar të Gjykatës Kushtetuese. Kuvendi vetëm ka shqyrtuar kandidaturat e paraqitura nga Presidenti, në pajtim me kërkesat e nenit 125/1 të Kushtetutës dhe praktikën e kësaj Gjykate.

7.2 Kuvendi ka vepruar në përputhje me vendimin nr. 24/2011 të kësaj Gjykate duke gjetur zgjidhjen e kërkuar me qëllim realizimin e përtëritjes me një të tretën çdo tre vjet të përbërjes së saj. Në këtë mënyrë, Kuvendi i ka dhënë zgjidhje një ngërçi kushtetues të krijuar jo prej tij por prej dispozitave kalimtare të Kushtetutës, siç është konstatuar edhe në vendimin nr. 24/2011 të kësaj Gjykate.

7.3 Kuvendi, në ushtrim të kompetencave të tij të njohura nga Kushtetuta, bazuar edhe në nenin 106/1/a të Rregullores së Kuvendit, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, nuk vepron vetëm me anë të ligjeve që ai miraton por edhe me anë të vendimeve, rezolutave, deklaratave dhe projekteve të tyre. Në këtë kuptim, aktet e Kuvendit nuk mund të konsiderohen si akte të brendshme apo administrative në kuptimin e ngushtë të tyre. Vendimi nr. 106/2011 i Kuvendit nuk është një akt i brendshëm i tij por një vendim që ka dalë në bazë dhe për zbatim të vendimit nr. 24/2011 të Gjykatës, me anë të të cilit i është lënë detyrë Kuvendit të gjejë mekanizmin e duhur për të realizuar përtëritjen e përbërjes së kësaj Gjykate me një të tretën çdo tre vjet.

7.4 Legjitimiteti i Gjykatës nuk mund të vihet në diskutim, pasi anëtarët e saj mund të qëndrojnë në detyrë deri në emërimin e anëtarëve të rinj, sipas nenit 125/5 të Kushtetutës. Kjo dispozitë ka pasur si qëllim shmangien e situatave bllokuese të këtij institucioni të natyrës së veçantë kushtetuese. Kuvendi, me anë të vendimit nr. 106/2011, nuk e ka zgjatur mandatin e anëtarëve të Gjykatës përtej 9 vjetëve, ai thjesht ka konstatuar se nuk ka vende vakante në këtë institucion deri në prill të vitit 2013, kur i bie përtëritja e radhës.

7.5 Kuvendi është organ i pavarur kushtetues dhe vendos brenda kompetencave të tij kushtetuese për rregullimin e çështjeve të ndryshme. Atij nuk mund t'i diktohet mënyra e veprimit në zgjidhjen e situatave të ndryshme. Gjetja e mekanizmit të duhur për realizimin e detyrimit që rrjedh nga neni 125/3 i Kushtetutës është në çmimin dhe diskrecionin e Kuvendit. Për këtë qëllim, Kuvendi vepron me të gjitha mjetet dhe procedurat që i njeh Kushtetuta dhe Rregullorja e tij dhe jo vetëm nëpërmjet miratimit të ligjeve formale.

II

Për pretendimin lidhur me legjitimitetin e kërkuesit

Gjykata e çmon me vend të ndalet fillimisht në çështjen e legjitimitetit të kërkuesit për të kërkuar zgjidhjen e konfliktit të kompetencave, për shkak se ky pretendim është ngritur nga subjekti i interesuar.

8. Gjykata, duke iu referuar natyrës dhe thelbit të pretendimeve të parashtruara gjatë gjykimit, vëren se kërkuesi kërkon zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet Presidentit dhe Kuvendit, e cila, sipas kërkuesit, ka ardhur si pasojë e nxjerrjes së vendimit nr. 106/2011 të Kuvendit. Gjykata e sheh të arsyeshme të ritheksojë edhe një herë qëndrimin e saj lidhur me elementet e domosdoshme të një mosmarrëveshjeje kompetence midis dy organeve, si kusht për t'iu drejtuar kësaj Gjykate me kërkesë për zgjidhjen e saj.

9. Në jurisprudencë të vazhdueshme, Gjykata ka theksuar se konflikti i kompetencave mund të ekzistojë nëse dy organe/pushtete pretendojnë ushtrimin e të njëjtës kompetencë, ose kur asnjëri prej dy organeve/pushteteve nuk merr përsipër ushtrimin e një kompetence (*vendime të Gjykatës Kushtetuese nr. 26/2006, nr. 20/2007; nr. 12/2008*). Nisur nga ky qëndrim, mosmarrëveshja e kompetencës mund të shtrohet në dy plane: njëri plan lidhet me rastin kur objekt i mosmarrëveshjes është ndërhyrja me akt normativ në kompetencat e një organi kushtetues, duke sjellë si pasojë pakësimin ose shtimin e kompetencave të tij. Në këtë rast, objekt i mirëfilltë i gjykimit kushtetues është vlerësimi *in abstracto* nëse ky ndryshim i kompetencave ka cenuar parimin kushtetues të ndarjes së pushteteve. Një plan tjetër

është rasti kur konflikti i mirëfilltë i kompetencave lidhet me faktin kur një apo disa organe nxjerrin akte që cenojnë sferën e kompetencave të organit tjetër. Në këtë rast, objekt i mirëfilltë i gjykimit kushtetues është vlerësimi *in concreto* nëse akti ka prekur kompetencat e një organi tjetër.

10. Në bazë të nenit 54/3 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” (ligji 8577/2000), ndërmjet të tjerash, që të iniciohet një çështje për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje kompetencash midis pushteteve përpara kësaj Gjykate, kërkesa duhet të ngrihet nga subjektet në konflikt ose nga subjektet e cenuara drejtpërdrejt nga konflikti. Në çështjen në shqyrtim, Presidenti, në pozitën e kërkuarit para kësaj Gjykate, i përqendron pretendimet e tij në mbrojtjen e sferës së veprimtarisë së vet, pra të ushtrimit të kompetencës për emërimin e anëtarëve të Gjykatës, parashikuar nga neni 125 i Kushtetutës. Kërkuari pretendon se nëpërmjet vendimit nr. 106/2011 të Kuvendit, me anë të të cilit është vendosur pezullimi i shqyrtimit të mëtejshëm të dekreteve të Presidentit për emërimin e anëtarëve të rinj të Gjykatës, i është cenuar realizimi i kompetencës së parashikuar nga neni 125/1 i Kushtetutës. *De facto*, dekretet e tij as nuk janë rrëzuar as nuk janë miratuar, gjë që, sipas tij, nuk është në përputhje me hapësirën e veprimit të Kuvendit, i cili ka për kompetencë t’i shqyrtojë dekretet në themelin e tyre dhe të shprehë një vullnet përfundimtar lidhur me to. Mosshqyrtimi i dekreteve, sipas kërkuarit, nuk është një alternativë që e ka në dorë ta zgjedhë Kuvendi.

11. Nisur nga pretendimet e kërkuarit, Gjykata vlerëson se në çështjen konkrete ndodhet para një situatë ku kërkuari pretendon se është cenuar në kompetencat e tij nga nxjerrja e një akti konkret të subjektit të interesuar. Vendimi nr. 106/2011 i Kuvendit, me anë të të cilit u vendos mosshqyrtimi i mëtejshëm i dekreteve të Presidentit, ka sjellë si pasojë mosardhjen e efekteve të pritura nga nxjerrja e dekreteve të Presidentit për emërimin e anëtarëve të rinj të Gjykatës. Për këtë arsye, Gjykata çmon se ndodhet para një ngërçi institucional që vjen si rrjedhojë e kuptimit të ndryshëm të nenit 125/5 dhe 127 të Kushtetutës, si dhe të vendimit nr. 24/2011 të kësaj Gjykate. Prandaj, Gjykata e sheh të nevojshme të ndalet së pari tek interpretimi i këtyre dispozitave kushtetuese dhe i vendimit të saj nr. 24/2011.

III

A. Për pretendimin mbi natyrën juridike të vendimit nr. 106/2011 të Kuvendit

12. Kërkuari pretendon se Kuvendi, me një akt të brendshëm individual, ka vendosur pezullimin e shqyrtimit të dekreteve të Presidentit, pa i shqyrtuar ato në seancë, gjë që nuk përputhet me kërkesat e Kushtetutës. Gjithashtu, Kuvendi, nëpërmjet këtij akti individual, ka zgjatur mandatin e anëtarëve të Gjykatës nga 9 në 12 vjet, tej parashikimeve të nenit 125/2 të Kushtetutës. Mandati i organeve të parashikuara nga Kushtetuta mund të zgjatet vetëm me ligj kushtetues dhe jo me akt individual të miratuar nga Kuvendi.

13. Subjekti i interesuar, në prapësimet e tij, ka parashtruar se Kuvendi, ndryshe nga sa pretendon kërkuari, në ushtrim të kompetencave të tij të njohura nga Kushtetuta, bazuar edhe në nenin 106/1/a të Rregullores së Kuvendit, nuk vepron vetëm me anë të ligjeve që ai miraton por edhe me anë të vendimeve, rezolutave, deklaratave dhe projekteve të tyre. Në këtë kuptim, sipas tij, aktet e Kuvendit nuk mund të konsiderohen si akte të brendshme apo administrative në kuptimin e ngushtë të tyre. Vendimi nr. 106/2011 i Kuvendit nuk është një akt i brendshëm i tij por një vendim që ka dalë me qëllim zbatimin e urdhërimeve të vendimit nr. 24/2011 të kësaj Gjykate. Sipas këtij vendimi është detyrë e Kuvendit të gjejë mekanizmin e duhur për të realizuar përtëritjen e përbërjes së kësaj Gjykate me një të tretën çdo tre vjet, sipas përcaktimit kushtetues.

14. Gjykata vlerëson se është e nevojshme të ndalet së pari te natyra juridike e aktit të nxjerrë nga Kuvendi, konkretisht vendimit nr. 106/2011, objekt shqyrtimi para kësaj Gjykate. Bazuar në nenin 106 të Rregullores së Kuvendit, që parashikon dokumentacionin parlamentar, në paragrafin 1 të tij parashikohet se: “*Dokumentacioni parlamentar përfshin: a) ligjet, vendimet, rezolutat, deklaratat e Kuvendit dhe projektet e tyre.*” Pra, Kuvendi në ushtrim të kompetencave të veta nxjerr, midis të tjerave, edhe vendime. Duke iu referuar objektit të vendimit nr. 106/2011 të Kuvendit që lidhet me dhënien e pëlqimit për dekretin e emërimit të tre anëtarëve të Gjykatës, rezulton se për nga natyra juridike ky vendim është një akt individual. Si i tillë, ai ka për qëllim rregullimin e një çështjeje konkrete, lidhur me



përtëritjen e përbërjes së Gjykatës Kushtetuese. Gjykata vlerëson se Kuvendi, nëpërmjet vendimit nr. 106/2011, duke iu referuar llojit të aktit, si dhe të gjithë procesit të zhvilluar në Kuvend lidhur me emërimin e anëtarëve të rinj të saj, ka vendosur ndërprerjen e procedurave të shqyrtimit të dekreteve të Presidentit për shkak se ka konstatuar mungesë vakance në këtë Gjykatë, duke iu referuar vendimit të kësaj të fundit për detyrimin e organeve kushtetuese për të respektuar qëndrimin në detyrë të 2/3 të anëtarëve të saj, si vlerë kushtetuese.

B. Për interpretimin e nenit 125/5 të Kushtetutës

15. Kërkuesi ka pretenduar se Kuvendi, nëpërmjet vendimit nr. 106/2011, ka pezulluar përtëritjen e përbërjes së Gjykatës, duke sjellë si pasojë qëndrimin në detyrë tej mandatit kushtetues prej 9 vjetësh të tre anëtarëve të pazëvendësuar, gjë që vë në diskutim legjitimitetin e saj.

16. Subjekti i interesuar e ka kundërshtuar këtë pretendim duke argumentuar se legjitimiteti i Gjykatës nuk mund të vihet në diskutim, pasi anëtarët e saj mund të qëndrojnë në detyrë deri në emërimin e anëtarëve të rinj, sipas nenit 125/5 të Kushtetutës. Ligjvënësi, në miratimin e kësaj dispozite, ka pasur si qëllim pikërisht shmangien e situatave bllokuese të këtij institucioni të natyrës së veçantë kushtetuese. Sipas subjektit të interesuar, Kuvendi nuk e ka zgjatur mandatin e anëtarëve të Gjykatës përtej afatit 9-vjeçar, ai thjesht ka konstatuar se nuk ka vende vakante në këtë institucion deri në prill të vitit 2013, kohë në të cilën do të zhvillohet përtëritja e radhës.

17. Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit lidhur me mungesën e legjitimitetit të saj për shkak të qëndrimit në detyrë tej afatit 9-vjeçar të tre anëtarëve është i pabazuar dhe nuk duhet pranuar. Në kushtet kur dy organe kushtetuese kanë bërë interpretime të ndryshme për normën kushtetuese, Gjykata, në mbështetje të nenit 124/1 të Kushtetutës, e sheh me vend të bëjë interpretimin përfundimtar të nenit 125/5 të Kushtetutës. Sipas nenit 125/5 të Kushtetutës, gjyqtari kushtetues qëndron në detyrë deri në ardhjen e gjyqtarit të ri. Ky rregullim kushtetues i jep legjitimitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm jo vetëm gjyqtarit kushtetues por edhe vendimmarrjes së Gjykatës në tërësi, me qëllim vazhdimësinë e drejtësisë kushtetuese, pavarësisht situatave të mundshme që mund të krijohen gjatë procesit të emërimit të anëtarëve të rinj. Neni 125/5 ka karakter detyrues dhe nuk mund të lihet në vlerësimin e gjyqtarëve kushtetues ose të subjekteve të tjera qëndrimi apo jo në detyrë pas përfundimit të mandatit, deri në emërimin e gjyqtarit të ri. Kushtetutbërësi qëllimisht ka parashikuar detyrimin e gjyqtarit, të cilit i ka përfunduar mandatin, të qëndrojë deri në emërimin e gjyqtarit të ri me qëllim që të mos krijohen situata bllokuese, të cilat passjellin mungesë sigurie dhe parashikueshmërie të kontrollit kushtetues në një shtet të së drejtës. Situata në të cilën ndodhet sot Gjykata, pra e qëndrimit në detyrë të tre anëtarëve të saj tej mandatit kushtetues 9-vjeçar, nuk është diçka e re për këtë institucion kushtetues, i cili në vazhdimësi është përbashkët me përtëritje të vonuara të përbërjes së tij nga dy organet që janë ngarkuar nga Kushtetuta për ta realizuar atë.

18. Rregullimi i nenit 125/5 të Kushtetutës ka qenë mjaft i qartë dhe qëllimi i tij duhet kërkuar pikërisht të ruajtja dhe garantimi i funksionit unik dhe të papërsëritshëm që ka Gjykata Kushtetuese në një shtet të së drejtës. Është pikërisht garantimi i pacenueshmërisë dhe i funksionimit normal të drejtësisë kushtetuese që merr më tepër rëndësi në këtë rast, si një vlerë e çmuar dhe e domosdoshme kushtetuese për ruajtjen e vazhdimësisë në vendimmarrje (*vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 24/2011*). Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se qëndrimi në detyrë i tre gjyqtarëve kushtetues tej mandatit 9-vjeçar nuk ka ardhur as si dëshirë apo veprim i gjyqtarëve kushtetues që u ka përfunduar mandatin dhe as si vullnet i kësaj Gjykate. Për këtë arsye, nuk është detyrë dhe as funksion i saj të marrë masa që anëtarët, të cilëve u ka përfunduar mandatin, të mos qëndrojnë në detyrë tej këtij mandati. Kjo është kompetencë e përbashkët e Presidentit dhe Kuvendit, të cilët, në kuadër të bashkëpunimit institucional, duhet të marrin të gjitha masat që Gjykata të ruajë vazhdimisht dhe në çdo kohë legjitimitetin e saj, pavarësisht situatave që mund të krijohen. Gjykata ka theksuar dhe e rithekson se zgjidhja e kësaj situatë nuk duhet pritur prej saj por prej organeve që kanë për detyrë dhe përgjegjësi të emërojnë dhe zgjedhin anëtarët e saj, si dhe të krijojnë kushtet e përshtatshme për një funksionim sa më normal të drejtësisë kushtetuese në vend (*vendim nr. 24/2011 i Gjykatës Kushtetuese*).

19. Legjitimiteti i kësaj Gjykate është një çështje e padiskutueshme, pasi ajo funksionon tërësisht brenda kritereve dhe kushteve të përcaktuara nga Kushtetuta. Funkcioni themelor i Gjykatës

është garantimi i respektimit të Kushtetutës, interpretimi përfundimtar dhe sigurimi i epërsisë së saj në sistemin ligjor, nëpërmjet dhënies së drejtësisë kushtetuese. Në këtë këndvështrim, Gjykata rithekson edhe një herë se *“rregulli i vazhdimësisë së qëndrimit në detyrë të gjyqtarit kushtetues është parashikuar për të garantuar, mbi të gjitha, funksionimin normal të Gjykatës në rast të krijimit të vendeve vakante, si pasojë e mosveprimit të ndonjërit prej organeve, të cilave Kushtetuta u njuh një rol të veçantë në këtë moment për zëvendësimin e gjyqtarëve të vjetër me gjyqtarë të rinj. Nisur edhe nga natyra kolegjiale e këtij organi të pavarur kushtetues, çdo mosveprim do të kishte pasoja në funksionimin e Gjykatës.”*(vendimi nr. 24/2011 i Gjykatës Kushtetuese).

Nga ana tjetër, Gjykata vlerëson se, ndërsa vazhdimi i qëndrimit në detyrë të gjyqtarëve kushtetues, sipas nenit 125/5 të Kushtetutës, përbën një detyrim për ta, kjo nuk do të thotë se Presidenti dhe Kuvendi mund të zgjasin tej çdo afati të arsyeshëm procedurat e zëvendësimit të tyre. Ata, bashkërisht, pa mbaruar ende mandati 9-vjeçar i gjyqtarëve, duhet të marrin masat e nevojshme si për përcaktimin e modaliteteve juridike procedurale, ashtu edhe për zëvendësimin e tyre brenda afateve procedurale të arsyeshme, me synim që të respektohet edhe detyrimi që buron nga neni 125/2 i Kushtetutës.

C. Për interpretimin e nenit 127/3 të Kushtetutës

20. Nisur edhe nga diskutimet në seancë plenare, si dhe nga vlerësimi në tërësi i çështjes, Gjykata e sheh të arsyeshme të ndalet edhe në përkufizimin e konceptit *“vakancë”* dhe *“përfundimi i mandatit”*, sipas nenit 127/3 të Kushtetutës. Neni 127 i Kushtetutës parashikon se: *“1. Mandati i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese mbaron kur: a) Dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi; b) Nuk paraqitet në detyrë pa arsye për më shumë se 6 muaj; c) Mbush moshën 70 vjeç; ç) Jep dorëheqjen; d) Deklarohet i paqftë për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë. 2. Mbarimi i mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese deklarohet me vendim të Gjykatës Kushtetuese. 3. Në rast se vendi i gjyqtarit mbetet vakant, Presidenti i Republikës emëron me pëlqimin e Kuvendit një gjyqtar të ri, i cili qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit të gjyqtarit të larguar.”*

21. Gjykata vlerëson se situatat që parashikon neni 127/1 i Kushtetutës janë të ndryshme nga ajo e përfundimit të mandatit të gjyqtarëve si pasojë e plotësimit të periudhës kohore prej 9 vjetësh. Rastet e nenit 127 janë të jashtëzakonshme dhe nuk lidhen me përfundimin e mandatit për shkak të kohëzgjatjes së tij të parashikuar nga neni 125/2 i Kushtetutës. Ato janë rastet e ndërprerjes së papritur të mandatit dhe për këtë arsye është ngarkuar Gjykata të deklarojë se ndodhet në kushtet e përfundimit para kohe të mandatit të gjyqtarit kushtetues. Për këtë arsye, Gjykata vlerëson se termi *“vakancë”* lidhet vetëm me rastet e parashikuara nga neni 127/1 i Kushtetutës dhe nuk ka të bëjë me përfundimin e kohëzgjatjes prej 9 vjetësh të mandatit të gjyqtarit kushtetues të parashikuar nga neni 125/2 i Kushtetutës. Në rastet kur mandati përfundon para kohe, pra sipas nenit 127/1, gjyqtari *“i vjetër”* nuk mund të rrijë asnjë ditë më shumë në detyrë, pasi efektet e vendimit janë të menjëhershme. Rastet e nenit 127/1 lidhen me situata të veçanta për të cilat Gjykata është e detyruar të deklarojë përfundimin e mandatit, pasi është ajo që konstaton ngjarjen, e cila bëhet shkak për zëvendësimin e gjyqtarit në detyrë. Ndërsa përfundimin e mandatit si rrjedhojë e plotësimit të kohëzgjatjes prej 9 vjetësh e konstaton, për shkak të detyrës, Presidenti, i cili është edhe iniciues i procesit të emërimit të anëtarëve të rinj. Përfundimi i mandatit, si rrjedhojë e plotësimit të afatit të caktuar, nuk është i nevojshëm të deklarohet, pasi nuk është nga ato raste të veçanta, që parashikon shprehimisht neni 127 i Kushtetutës. Lidhur me mbarimin normal, të zakonshëm dhe në afatin e caktuar të mandatit, Kushtetuta nuk parashikon ndonjë procedurë të caktuar dhe as organin konkret që duhet të shprehet dhe të deklarohet për të. Mjafton plotësimi i afatit të caktuar kohor për organin ose funksionin konkret që mandati të konsiderohet i përfunduar normalisht dhe organi kompetent të fillojë procedurat për zgjedhjen e personit tjetër (vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 51/1999).

22. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se kur gjyqtarit kushtetues i përfundon mandati i plotë prej 9 vjetësh, sipas nenit 125/2 të Kushtetutës, ai pasohet në detyrë sipas rregullit nga një gjyqtar i ri, i cili nuk është zëvendësues i tij, siç është rasti te neni 127/3 i Kushtetutës, por është një gjyqtar që emërohet për një mandat të plotë 9-vjeçar. Në rastet kur gjyqtarit kushtetues i përfundon mandati 9-vjeçar, ai qëndron në detyrë deri në emërimin e gjyqtarit të ri. Kjo rezervë është lënë me qëllim që të mos



bllokohet funksionimi normal i Gjykatës, në kushtet kur nuk ndodhet para rasteve të parashikuara nga neni 127 i Kushtetutës.

23. Si në rastet e përfundimit para kohe të mandatit të një gjyqtari, ashtu edhe në përfundimin normal të mandatit, zëvendësimi i tij nga organet e ngarkuara me emërimin e gjyqtarëve kushtetues, pra Presidenti dhe Kuvendi, duhet të bëhet brenda një afati të arsyeshëm, me qëllim që të realizohet detyrimi kushtetues i nenit 125/5 të Kushtetutës dhe gjithashtu të mos bllokohet vendimmarrja e Gjykatës. Për këtë arsye, në nenin 9/3 të ligjit 8577/2000 parashikohet detyrimi i Presidentit për të emëruar një gjyqtar të ri, brenda një muaji nga data kur mandati i gjyqtarit në detyrë përfundon para afatit. Gjyqtari i ri do të qëndrojë në detyrë deri në përfundim të mandatit të gjyqtarit të larguar. Në këtë mënyrë garantohet vazhdimësia e veprimtarisë së Gjykatës dhe e mandatit kushtetues që mbart gjyqtari i saj.

D. Për pretendimin lidhur me konfliktin e kompetencave midis Presidentit dhe Kuvendit për emërimin e anëtarëve të rinj të Gjykatës

24. Kërkuesi pretendon se, me anë të vendimit nr. 106/2011 të Kuvendit, atij i është cenuar kompetenca për të emëruar anëtarët e Gjykatës, pasi Kuvendi vendosi pezullimin e shqyrtimit në themel të kandidaturave. Sipas tij, në këtë mënyrë, Kuvendi e ka penguar Presidentin në ushtrimin e kompetencave të tij kushtetuese, të parashikuara nga neni 125/1 i Kushtetutës, pasi dekretet e tij, si rrjedhim i veprimit të Kuvendit, nuk sollën asnjë pasojë juridike. Kuvendi duhej ose t'i rrëzonte ose t'i miratonte ato dhe jo t'i kthente pa veprim.

25. Subjekti i interesuar argumenton se Kuvendi në asnjë rast nuk pasur si qëllim marrjen apo pengimin e ushtrimit të ndonjë kompetence të Presidentit. Sipas tij, ai ka vepruar në përputhje me Kushtetutën dhe në zbatim të vendimit nr. 24/2011 të Gjykatës, e cila ka kërkuar gjetjen e një mekanizmi të përshtatshëm për zgjidhjen e situatës së krijuar gjatë përtëritjes së përbërjes së kësaj Gjykate. Kuvendi në asnjë rast nuk ka emëruar vetë ndonjë kandidat për anëtar të Gjykatës duke anashkaluar Presidentin, ai vetëm është kujdesur për të rikthyer gjendjen normale në përtëritjen e përbërjes e saj.

26. Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit është i pabazuar dhe nuk duhet pranuar. Për të arritur në një përfundim lidhur me ekzistencën ose jo të mosmarrëveshjes së pretenduar nga kërkuesi, Gjykata rithekson edhe një herë se kërkuesi duhet të parashtrojë se midis cilave organe ekziston konflikti, cila është kompetenca që ushtrohet nga organi tjetër dhe në ç'mënyrë pengohet ushtrimi i saj ose në ç'mënyrë një organ e ushtron pa të drejtë një kompetencë të një organi tjetër. Nëse këto elemente nuk identifikohen nga Gjykata në kërkesën e parashtuar asaj, ajo nuk mund të arrijë në një përfundim të qartë se cilit organ i takon të ushtrojë cilën kompetencë, si qëllimi final i shqyrtimit dhe kontrollit që bën kjo Gjykatë, referuar nenit 56/1 të ligjit nr. 8577/2000 dhe praktikës së saj të konsoliduar në këtë drejtim (*vendime të Gjykatës Kushtetuese nr. 26/2006; nr. 20/2007; nr. 12/2008*).

27. Gjykata konstaton se pretendimi i Presidentit për mosmarrëveshje kompetence lidhet me tagrin e tij për të emëruar anëtarët e kësaj Gjykate. Nisur nga ky fakt, megjithëse çështja e emërimit të gjyqtarëve kushtetues është shqyrtuar më shumë se një herë nga kjo Gjykatë, shihet si e nevojshme të interpretohen edhe një herë linjat e vendosura prej saj në vendimmarrjet e mëparshme lidhur me këtë proces të rëndësishëm kushtetues. Gjykata në vendimmarrjen e saj është shprehur se "*procedura e emërimit (të gjyqtarëve) karakterizohet ose nga ndarja e kompetencës së zgjedhjes së gjyqtarëve midis shumë organeve ose institucioneve të shtetit, ose, në raste të tjera, nga kooperimi i institucional i dy ose më shumë organeve në caktimin e gjyqtarëve, ose si një procedurë ekskluzivisht (ose pothuajse) parlamentare për zgjedhjen e gjyqtarëve, ku hyn në lojë pluralizmi konkurrencial i partive politike që marrin pjesë dhe nevoja për kërkimin e një konsensusi midis tyre. Në rastin në shqyrtim, sistemi i emërimit i pranuar nga Kushtetuta e Shqipërisë ka në esencë kooperimin institucional të Presidentit të Republikës dhe të Kuvendit të Shqipërisë... Ky sistem emërimi, i adoptuar nga Kushtetuta, i vë subjektet që përfshihen në të para kërkesës së respektimit të parimit të luajalitetit kushtetues, i cili shpreh, në thelb, respektin e ndërsjellë nga secili subjekt ndaj kompetencave të tjetrit, si dhe nënkupton krijimin e një raporti bashkëpunimi midis tyre. Në rastin në shqyrtim, ky parim kërkon nga Presidenti i Republikës dhe Kuvendi i Shqipërisë, që në zgjedhjen e çdo gjyqtari të udhëhiqen nga i njëjti objektivi për të siguruar një përbërje cilësore dhe të përshtatshme të Gjykatave"* (vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2005).

28. Gjithashtu, kjo Gjykatë ka rikonfirmuar edhe më pas këtë qëndrim duke theksuar se *“pëlqimi që kërkojnë normat e mësipërme kushtetuese nënkupton ... konsensus midis dy organeve kushtetuese që përfshihen në procesin e emërimit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë. Pjesëmarrja e Kuvendit në këtë proces ka për qëllim balancimin e kompetencës së Presidentit në emërimin e gjyqtarëve dhe kjo vjen në harmoni edhe me parimin e ndarjes dhe të balancimit ndërmjet pushteteve, të parashikuar në nenin 7 të Kushtetutës. Në këtë vështrim, pjesëmarrja e Kuvendit në procesin e emërimit të gjyqtarëve, që shkon tej një kontrolli juridik të procesit, është në harmoni të plotë me natyrën politike të këtij organi”* (vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 24/2011).

29. Këto linja të vendosura nga Gjykata i shërbejnë një qëllimi final: sigurimit të një përbërjeje sa më cilësore dhe të përshtatshme të Gjykatës, si organ kushtetues i natyrës së veçantë në një shtet demokratik, i cili, në shkallë të fundit, ka për mision ruajtjen dhe garantimin e parimeve kushtetuese. Siç përcaktohet edhe në nenin 124 të Kushtetutës, Gjykata si garantuese e respektimit të Kushtetutës dhe interpretuese përfundimtare e saj, është e pazëvendësueshme në funksionin e saj. Për këtë arsye, garantimi i mirëfunksionimit të saj në mënyrë të vazhdueshme duhet të jetë objektiv primar i organeve të ngarkuara nga Kushtetuta me këtë kompetencë. Për këtë arsye, Gjykata rithekson se kompetencat e Presidentit dhe të Kuvendit në procesin e emërimit të gjyqtarëve kushtetues jo vetëm nuk përjashtojnë njëra-tjetrën por, përkundrazi, ato shtrojnë nevojën e bashkëpunimit institucional gjatë të gjithë procesit të plotësimit të përbërjes së kësaj Gjykate.

30. Në çështjen konkrete për shqyrtim para kësaj Gjykate rezulton se Presidenti ka nxjerrë disa dekrete për emërimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të cilat ia ka dërguar Kuvendit për dhënien e pëlqimit. Ato (dekrete) janë shqyrtuar nga Kuvendi (konkretisht nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut), i cili ka arritur në përfundimin se shqyrtimi në themel i dekreteve të Presidentit nuk mund të bëhet, pasi aktualisht nuk ka vende vakante në këtë Gjykatë. Ky ka qenë interpretimi që Kuvendi i ka bërë vendimit nr. 24/2011 të kësaj Gjykate.

31. Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se ka një mungesë bashkëpunimi institucional midis Presidentit dhe Kuvendit lidhur me ushtrimin e kompetencës së tyre për përtëritjen e përbërjes së saj me anëtarë të rinj. Gjykata, duke mbajtur parasysh të gjithë procesin e zhvilluar, si nga ana e Presidentit ashtu edhe nga ana e Kuvendit, para dhe pas daljes së vendimeve nr. 2/2005 dhe nr. 24/2011 të saj, vlerëson se midis dy organeve kompetente për emërimin e anëtarëve të rinj të saj, nuk ka pasur bashkëpunim institucional, siç e kërkon fryma e Kushtetutës dhe jurisprudenca e kësaj Gjykate. Ashtu siç e ka pranuar kjo Gjykatë në jurisprudencën e saj, procesi i emërimit të gjyqtarëve kushtetues nuk është thjesht një proces juridik. Ai është një proces gjithëpërfshirës, ku shqyrtohet ekzistenca e vakancës, kriteret e emërimit, kualifikimi i kandidatit, qëndrimi i tij socialo-politik ndaj çështjeve të ndryshme të drejtësisë në përgjithësi dhe asaj kushtetuese në veçanti. Procesi i emërimit dhe i votimit të kandidaturave shkon përtej të qenit *“jurist i kualifikuar me 15 vjet përvojë”*. Ai duhet të mishërojë edhe elemente të vullnetit politik, juridik dhe moral të organeve të përfshira në këtë proces kushtetues, natyrisht duke ruajtur pavarësinë prej tyre. Organet e përfshira në procesin e emërimit duhet të gjejnë paraprakisht gjuhën dhe mekanizmin e duhur jo thjesht për të kryer detyrimin kushtetues në mënyrë mekanike, pra plotësimin me çdo kusht të vendeve vakante në Gjykatën Kushtetuese. Ato duhet të bashkëpunojnë për të bërë të mundur funksionimin normal, cilësor dhe koherent të kësaj Gjykate edhe sikur për të arritur këtë qëllim do të duhej të shpenzohej më tepër kohë dhe energji se normalisht. Pikërisht këtu e ka vënë theksin Gjykata në vendimin nr. 24/2011, pra që funksionimi normal i drejtësisë kushtetuese, vazhdimësia dhe koherenca në vendimmarrjen e saj janë primare. Çdo gjë tjetër që lidhet me përbërjen e saj (përtëritja, përzgjedhja e kandidatëve, qëndrimi në detyrë tej mandatit etj.) duhet të jetë në funksion të këtij qëllimi për shkak të rëndësisë që ka vendimmarrja e kësaj Gjykate në një shtet të së drejtës.

32. Gjithashtu, Gjykata, në vendimet e saj të mëparshme (vendimet nr. 2/2005 dhe nr. 24/2011), ka theksuar detyrimin e Presidentit për të bashkëpunuar me Kuvendin. Arsyeja përse Kuvendi ka rolin kryesor për zgjidhjen e situatës ku ndodhet sot kjo Gjykatë është fakti se ai është i vetmi organ që përfaqëson drejtpërdrejt vullnetin demokratik të shumicës së zgjedhësve dhe, në këtë kontekst, ka detyrimin dhe përgjegjësinë për të rregulluar një situatë ngërçi. Megjithatë, ky fakt nuk e përjashton Presidentin nga përgjegjësia dhe detyrimi për të bashkëpunuar me Kuvendin. Bashkëpunimi është një



proces që kërkon vullnet dhe angazhim të dyanshëm gjatë të gjithë kohës së nevojshme për të realizuar përtëritjen e përbërjes së Gjykatës. Ai mund të realizohet me mënyra e mjete të ndryshme nga të dyja institucionet kushtetuese duke filluar që në momentin e përzgjedhjes paraprake të kandidatave për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese ose të Gjykatës së Lartë. Në çështjen e shtruar për shqyrtim para saj, Gjykata konstaton se nuk ka pasur bashkëpunim midis Presidentit dhe Kuvendit për të kryer përtëritjen e përbërjes së saj, sipas frymës së Kushtetutës dhe vendimeve të dhëna prej saj lidhur me këtë çështje.

33. Gjykata rithekson se nuk është detyrë e saj të analizojë shkaqet që çuan në mungesën e bashkëpunimit institucional midis tyre, megjithatë ajo çmon se çështja e mundësisë së përtëritjes së gjashtë gjyqtarëve kushtetues në vend të tre prej tyre (siç është kërkesa e nenit 125/3 të Kushtetutës) ka qenë e njohur të paktën prej hyrjes në fuqi të Kushtetutës në vitin 1998 dhe më pas të ligjit nr. 8577/2000, që parashikuan vazhdimin e mandatit 12-vjeçar të anëtarëve të Gjykatës që ishin emëruar para hyrjes në fuqi të Kushtetutës. Pra, si Presidenti ashtu dhe Kuvendi kanë pasur dijeni për situatën dhe problematikën e përtëritjes së përbërjes së kësaj Gjykate. Po ashtu, Gjykata, nëpërmjet vendimeve të saj, e ka bërë të ditur se kompetenca për të rregulluar këtë situatë i takon Kuvendit dhe se bashkëpunimi midis Presidentit dhe Kuvendit duhet të jetë i pranishëm në çdo rast të emërimit të anëtarëve të kësaj Gjykate.

34. Gjykata rithekson se ushtrimi i së drejtës dhe detyrimit kushtetues për të plotësuar përbërjen e saj nuk do të thotë thjesht ushtrimi i kompetencës së nxjerrjes së dekretëve pa realizuar më parë bashkëpunimin me organin tjetër që në fazën e përzgjedhjes së kandidatave e më pas të miratimit të tyre përfundimtar. Pa një bashkëpunim të tillë midis dy organeve të përfshira në procesin e emërimit të anëtarëve të Gjykatës, efektet e këtij procesi nuk mund të jenë në përputhje me frymën e Kushtetutës dhe të jurisprudencës së kësaj Gjykate. Duke iu referuar deklaratimeve të përfaqësuesit të kërkuarit në seancë se, në rastin konkret, për të respektuar kompetencën e Presidentit, do të ishte i mjaftueshëm votimi formal i dekretëve, pra ose të rrëzohen ose të miratohen nga Kuvendi, para Gjykatës ngrihen pikëpyetje lidhur me kuptimin e thelbit të rolit të Presidentit në këtë proces. Gjykata çmon se një situatë e tillë ku dekretet e Presidentit, pas shqyrtimit tërësisht formal të tyre, do të vazhdonin rregullisht të rrëzoheshin nga Kuvendi, pasi ky i fundit ka deklaruar mungesën e vakancës në këtë Gjykatë, nuk është në përputhje me parimin e kooperimit institucional të elaboruar nga praktika e kësaj Gjykate.

35. Gjykata çmon gjithashtu se kompetenca e Presidentit nuk ka arritur të finalizohet në Kuvend me shqyrtimin në themel të dekretëve si pasojë e ushtrimit të kompetencës së tij në mungesë të kooperimit institucional mes dy organeve kushtetuese. Mosshqyrtimi i dekretëve nga ana e Kuvendit ka ardhur si pasojë e interpretimit origjinal që ligjvënësi i ka bërë dispozitave kushtetuese, si dhe vendimit nr. 24/2011 të kësaj Gjykate për të realizuar përtëritjen e përbërjes së saj me një të tretën çdo tre vjet në funksion të ruajtjes së vazhdimësisë dhe koherencës në vendimmarrjen e këtij organi kushtetues. Parë në këtë kontekst, është detyrë jo vetëm e Presidentit por edhe e Kuvendit të marrë masat e duhura që përbërja e Gjykatës të jetë në përputhje me kërkesat e dispozitave kushtetuese. U takon këtyre dy organeve të zgjidhin situatën e krijuar sa i takon përtëritjes së detyrueshme të kësaj Gjykate me një të tretën çdo tre vjet, duke ruajtur funksionimin normal dhe koherent të drejtësisë kushtetuese.

36. Nisur nga sa më sipër, kompetenca thelbësore për zgjedhjen e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe përgjegjësia për ruajtjen e legjitimitetit të saj, i takon si Presidentit ashtu edhe Kuvendit. Kjo është dhe arsyeja që kjo Gjykatë ka përcaktuar si “*shqyrtim në themel/meritë*” procesin që zhvillohet nga të dyja këto organe për plotësimin e vakancave në përbërjen e saj (*vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2005*). Duke qenë se kjo është kompetencë dhe përgjegjësi thelbësore e Kuvendit, e cila ndahet në procesin paraprak me Presidentin për të rritur besimin e publikut te përzgjedhja e kandidatave, Kuvendi në asnjë rast nuk mund dhe nuk duhet të mjaftohet me miratimin ose rrëzimin automatik të kandidatave për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese që propozohen nga Presidenti. Kuvendi e zhvillon procesin e shqyrtimit të kandidatave të propozuara nga Presidenti jo vetëm për të çuar deri në fund procesin e filluar prej këtij të fundit, por, në radhë të parë, për të garantuar legjitimitetin e organit që nevojitet të plotësohet me anëtarë të rinj. Pra, përgjegjësia në këtë proces bie mbi të dyja organet kushtetuese.

37. Në këtë këndvështrim, në rastin konkret, Gjykata konstaton se Kuvendit iu dërguan për miratim katër kandidatura të propozuara nga Presidenti, për të cilat Kuvendi gjatë procesit të shqyrtimit të tyre, arriti të ngrinte dyshime sa i takon ekzistencës së katër vendeve vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe si rrjedhojë edhe të nevojës për t'i plotësuar ato. Për këtë arsye, Kuvendi vendosi t'i drejtohej kësaj Gjykate për interpretim të dispozitave kushtetuese lidhur me realizimin e përtëritjes së përbërjes me një të tretën çdo tre vjet si detyrim kushtetues dhe ligjor. Gjykata, në vendimin e saj nr. 24/2011, e vlerësoi si të domosdoshëm plotësimin e detyrimit për realizimin e përtëritjes, me kusht që të ruhet vazhdimësia dhe koherenca institucionale e saj, si organ i posaçëm kushtetues. Nisur nga ky vlerësim i Gjykatës, Kuvendi, si organi më i lartë ligjvënës, duhej të gjente një mënyrë që përbërja e kësaj Gjykate të përtërihej sipas konceptit kushtetues të trajtuar prej saj. Për të ruajtur vlerën kushtetuese të vazhdimësisë dhe koherencës në vendimmarrjen e Gjykatës, Kuvendi vlerësoi se mënyra më e përshtatshme për ta realizuar atë ishte dhënia e pëlqimit vetëm për një dekret për emërim të anëtarit të Gjykatës dhe mosshqyrtimin e mëtejshëm të tri dekreteve të tjera të Presidentit deri në përtëritjen e radhës, me qëllim që të ruhej mazhoranca prej 2/3 e përbërjes së kësaj Gjykate.

38. Si përfundim, Gjykata vlerëson se situata e krijuar midis Presidentit dhe Kuvendit nuk është nga ato që mund të gjejë zgjidhje në rrugën e kontrollit kushtues, konkretisht të zgjidhjes së mosmarrëveshjes së kompetencës midis organeve. Gjykata e pranon se ekziston një situatë jo e zakonshme që ka ardhur si pasojë e një dispozite kushtetuese kalimtare dhe e ligjit nr. 8577/2000 për zgjidhjen e së cilës ajo (Gjykata) ka përcaktuar organet përgjegjëse duke theksuar mungesën e kompetencës së saj për të plotësuar mangësitë në legjislacion apo për të sugjeruar mjetin/mekanizmin më të mirë për zgjidhjen e saj. Pretendimet lidhur me përshtatshmërinë e mekanizmit të gjetur prej Kuvendit për të zgjidhur këtë situatë të krijuar dhe njëkohësisht për të realizuar përtëritjen e kësaj Gjykate me një të tretën e saj çdo tre vjet, shkojnë tej juridiksionit të saj. Ajo nuk mund të sugjerojë ose të refuzojë mënyrën ose mjetin e përdorur nga ligjvënësi për të rregulluar këtë çështje. Një gjë e tillë del jashtë rolit të kontrollit kushtetues dhe si e tillë nuk mund të përfshihet në hapësirën e gjykimit të saj. Gjykata ka theksuar tashmë rolin dhe përgjegjësinë e dy organeve kushtetuese, Presidentit dhe Kuvendit, në funksion të luajalitetit kushtetues gjatë procesit të emërimit të anëtarëve të rinj të saj. Në këtë aspekt, u takon këtyre dy organeve që gjatë këtij procesi të shmangin çdo pengesë institucionale ose ligjore (*vendim nr. 24/2011 i Gjykatës Kushtetuese*).

39. Gjykata çmon se veprimi i Kuvendit për mosshqyrtimin e dekreteve deri në prill 2013, kohë në të cilën duhet të zhvillohet përtëritja e radhës, nuk ka pasur për qëllim pengimin e kompetencës së Presidentit për emërimin e anëtarëve të rinj të kësaj Gjykate, gjë të cilën ai e ka realizuar. Kuvendi, me anë të vendimit të tij nr. 106/2011, ka synuar rregullimin e një situatë jo të zakonshme në përtëritjen e Gjykatës, gjë e cila peshon më shumë në këtë rast. Në këtë kontekst, Gjykata nuk arrin të konstatojë se, nëpërmjet vendimit nr. 106/2011 të Kuvendit me të cilin u vendos mosshqyrtimi i dekreteve të Presidentit deri në përtëritjen e ardhshme të kësaj Gjykate, Presidentit i është marrë kompetenca për emërimin e gjyqtarëve kushtetues apo është penguar në ushtrimin e saj.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 134/1/a, 125 dhe 127 të Kushtetutës, si dhe të nenit 54 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Admir Thanza

Anëtarë kundër: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Petrit Plloçi



MENDIM PAKICE

Për arsye se kam një bindje të ndryshme juridike për mënyrën e zgjidhjes së kësaj çështjeje, e çmoj të shprehem në mendim pakice. Paraprakisht, dua të evidentoj rëndësinë e parimit të *luajalitetit kushtetues* mes institucioneve kushtetuese në konflikt kompetence dhe nëse ky parim është respektuar në rastin konkret.

1. Kompetenca e Presidentit për *emërimin* e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese (në vijim “GJK”) dhe kompetenca e Kuvendit për *dhënien e pëlqimit* për emërimet, janë kompetenca që të ushtruara *së bashku* përmbushin dhe përfundojnë detyrën funksionale kushtetuese të këtyre dy institucioneve, plotësimin e vendeve vakante në Gjykatën Kushtetuese. Duke qenë se ky detyrim kushtetues nuk mund të realizohet i vetëm, kuptohet rëndësia që merr bashkëpunimi mes institucioneve të përfshira në këtë proces, si vlerë kushtetuese dhe si komponent i munguar në demokracitë e reja¹, përtej leximit *ad litteram* të dispozitave kushtetuese.

2. Gjykata Kushtetuese ka theksuar se, pjesëmarrja e Kuvendit të Shqipërisë në procesin e përzgjedhjes së gjyqtarëve kushtetues, ka për qëllim balancimin e kompetencës së Presidentit të Republikës në emërimin e gjyqtarëve, dhe kjo vjen në harmoni edhe me parimin e ndarjes dhe *balancimit* ndërmjet pushteteve, të parashikuar në nenin 7 të Kushtetutës. Sistemi i emërimit, i pranuar nga Kushtetuta e Shqipërisë, ka në esencë *kooperimin institucional* të Presidentit të Republikës dhe të Kuvendit të Shqipërisë². Megjithëse pushtetet janë të ndara në aspektin e autonomisë funksionale dhe në pavarësinë e ushtrimit të detyrave të ngarkuara nga Kushtetuta, ato balancojnë njëra-tjetrën nëpërmjet bashkëveprimit ndërmjet tyre për ushtrimin e detyrave, duke respektuar, nxitur, mbështetur dhe kontrolluar njëra-tjetrën³.

3. Në një shtet demokratik, parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve nuk kërkon vetëm mosndërhyrjen në kompetencat e organeve që u përkasin pushteteve të ndryshme, por gjithashtu kërkon dhe bashkëpunimin reciprok mes tyre, përderisa qëllimi i përveçëm i çdo organi që i përket pushteteve të ndryshme është *forcimi i demokracisë* në interes të vendit⁴.

4. Parimi i bashkëpunimit institucional ka dy dimensione: negativ dhe pozitiv; *negativ* sepse nuk duhet ndërhyrë dhe duhen respektuar kompetencat e secilit organ nga tjetri dhe *pozitiv* sepse duhet bashkëpunuar në mënyrë aktive dhe duhet mbështetje mes organeve, me qëllim përmbushjen e detyrimeve kushtetuese.

5. Nga shqyrtimi i çështjes rezulton se dy organet e përfshira në procesin e përzgjedhjes së anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, Presidenti dhe Kuvendi, kanë pasur këto komunikime:

5.1. Presidenti, me shkresën e datës 28.07.2011, i është drejtuar Kuvendit duke i kërkuar votimin e dekreteve dhe, njëkohësisht duke i shprehur qëndrimin e tij se pezullimi i shqyrtimit të dekreteve nuk është në përputhje me Kushtetutën dhe me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 24/2011.

5.2. Kuvendi, me shkresën e datës 8.8.2011, i është përgjigjur, duke i konfirmuar qëndrimin mbi faktin se çështja e emërimit të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese është çështje e mbyllur deri në prill 2013.

6. Siç konstatohet, ka pasur vetëm dy komunikime, të pamjaftueshme për një *bashkëpunim pozitiv* mes dy institucioneve, të cilat për më tepër janë realizuar pas momentit të pezullimit të procedurave mbi votimin e dekreteve të Presidentit nga Kuvendi. Për rrjedhojë, vlerësoj se Presidenti dhe Kuvendi nuk kanë bashkëpunuar për të nxitur njëri-tjetrin në plotësimin e detyrimeve kushtetuese, duke sjellë si rezultat bllokimin e procesit të përzgjedhjes së anëtarëve të rinj të Gjykatës Kushtetuese, rezultat i papranueshëm në aspektin kushtetues. Sikundër dhe Gjykata Kushtetuese Rumune, në një

¹ Grabenwarter Christoph (anëtar i Komisionit të Venecias, ish-gjyqtar në GJEDNJ); “*Separation of powers and the independence of Constitutional Courts and Equivalent Bodies*”; 2nd Congress of the World Conference on Constitutional Justice, Rio de Janeiro- Brazil, 16 January 2011.

² Vendim nr. 2, datë 19.1.2005 i Gjykatës Kushtetuese.

³ Vendim nr. 11, datë 27.5.2004 i Gjykatës Kushtetuese.

⁴ Çështja nr. 2009-11-01, prg. 8.1, vendim i datës 18 janar 2010 të Gjykatës Kushtetuese të Latvia-s.

vendim të saj ka vlerësuar: “...një nga kërkesat për të plotësuar objektivin e përcaktuar në Kushtetutë, garantimin e shtetit të së drejtës, është dhe funksionimi i duhur mes autoriteteve publike sipas parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, **por pa bllokime institucionale**”⁵.

7. Përveç mungesës së bashkëpunimit institucional si përjasje e të dyja palëve në konflikt në kundërshtim me frymën dhe dispozitat kushtetuese, mendoj se zgjedhja e Kuvendit nëpërmjet vendimit nr. 106, datë 23.06.2011, me anë të të cilit ka *pezulluar* shqyrtimin e dekreteve të Presidentit për emërimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, deri në prill të vitit 2013, i ka thelluar mosmarrëveshjet kushtetuese, duke penguar Presidentin në ushtrimin e kompetencave që Kushtetuta i atribuon.

8. Sipas Kushtetutës, Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese vazhdon në detyrë deri në emërimin e pasardhësit të tij⁶. *Racionalja* e kësaj dispozite është se gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të qëndrojnë në detyrë deri në përfundimin e *procedurave të nevojshme* për emërimin e anëtarëve të rinj, brenda një afati të arsyeshëm, argument i pranuar dhe nga shumica (*prg. 19 i vendimit*). Edhe pse Kushtetutës dhe ligjit organik të GJK-së i mungojnë afate të përcaktuara në drejtim të përfundimit të procedurave të nevojshme për emërimin e anëtarëve të rinj, kjo nuk do të thotë që procedura e emërimit të gjyqtarit pasardhës të jetë jashtë kohës së arsyeshme, të nevojshme për këtë qëllim. Legjislacione të vendeve të tjera ofrojnë një rregullim të saktë dhe të qartë të procedurës së përzgjedhjes së gjyqtarit pasardhës, duke specifikuar momentin e fillimit të procedurës së përzgjedhjes dhe përfundimin e këtij procesi, duke përcaktuar dhe afatet kohore ligjore të detyrueshme për zbatim në përmbyllje të kësaj procedure.⁷

9. Po sipas nenit 125/2 të Kushtetutës, gjyqtarët emërohen për një mandat 9-vjeçar. Në rastin konkret tre (3) prej anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese u kishte mbaruar mandati kushtetues 9-vjeçar. Presidenti paraqiti para Kuvendit 3 dekretet për emërimin e gjyqtarëve të rinj në funksion të plotësimit të vendeve vakante të krijuara për shkak të mbarimit të mandatit të tre gjyqtarëve. Me vendimin nr. 106, datë 23.6.2011, Kuvendi vendosi pezullimin e procedurave të emërimit të tre anëtarëve të rinj të Gjykatës Kushtetuese deri në prill 2013. Në këtë kontekst, duke u zgatur mandati i tre prej anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese deri në vitin 2013, është penguar Presidenti në ushtrimin e detyrës funksionale që Kushtetuta i atribuon, plotësimi i vendeve vakante në Gjykatën Kushtetuese, detyrë e cila fillon me dekretin e emërimit të anëtarëve të rinj të Gjykatës Kushtetuese dhe përmbillet me betimin para Presidentit të anëtarëve të zgjedhur sipas nenit 129 të Kushtetutës⁸.

10. Sipas nenit 125/3 të Kushtetutës “Përbërja e Gjykatës Kushtetuese përtërihet çdo tre vjet në një të tretën e saj sipas procedurës së caktuar me ligj”. Kjo dispozitë reflektohet edhe në ligjin organik të Gjykatës Kushtetuese, në nenin 7/3, ku përcaktohet se: “Përbërja e Gjykatës Kushtetuese përtërihet çdo 3 vjet në një të tretën e saj, sipas procedurës së caktuar në këtë ligj”.

11. Kjo dispozitë kushtetuese është interpretuar nga GJK me vendimin nr. 24, datë 09.06.2011, si vijon: “1. Parashikimi i nenit 125/3 të Kushtetutës përbën një parim organizativ, i bazuar në veçoritë specifike të procesit kushtetues dhe që ka për qëllim ruajtjen në përbërje të Gjykatës Kushtetuese të një shumice prej dy të tretave të anëtarëve në detyrë, duke bërë të mundur krijimin e një përvoje juridike të posaçme në fushën e gjykimit kushtetues. Kjo përvojë e përfutur nga Gjykata, duke qenë se ka një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e vendimmarrjes së saj, konsiderohet një vlerë e mbrojtur nga Kushtetuta. 2. Gjetja dhe zbatimi i një *mekanizmi të përshtatshëm*, për të respektuar nenin 125/3 të Kushtetutës, është kompetencë e *ligjvënësit kushtetues*”.

12. Nga ky vendim Kuvendi duhet të kishte evidentuar dy elemente bashkërenduese të detyrueshme për respektim nga ana e tij: i) gjetjen e *mekanizmit të përshtatshëm* për të respektuar përbërjen e shumicës prej 2/3 të anëtarësisë së Gjykatës; dhe ii) kompetencën e *ligjvënësit kushtetues* për përcaktimin e këtij mekanizmi.

⁵ *Perifrazim* nga vendimi nr. 98, i datës 7 shkurt 2008.

⁶ Neni 125/5.

⁷ Neni 7/1 i ligjit nr. 03/L-121 mbi Gjykatën Kushtetuese të Kosovës: 1. Procedura për emërimin e gjyqtarit të ri, sipas këtij ligji, fillon në paktën tre (3) muaj para përfundimit të mandatit të rregullt të gjyqtarit paraprak. 2. Mandati i gjyqtarit të ri fillon në ditën kur përfundon mandati i gjyqtarit paraprak.

⁸ Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese fillon detyrën pasi bën betimin para Presidentit të Republikës.



13. Para Gjykatës Kushtetuese u pretendua nga Presidenti se vendimi nr. 106 si mekanizëm i zgjedhur nga Kuvendi për zbatimin e vendimit të saj nr. 24/2011, nuk është mekanizmi i duhur. Sipas shumicës, Kuvendi nëpërmjet vendimit nr. 106/2011 ka bërë një interpretim të vendimit nr. 24/2011 të Gjykatës Kushtetuese. Ajo ka vlerësuar se nuk ka juridiksion për kontrollin e përshtatshmërisë së mekanizmit të gjetur nga Kuvendi (*prg. 30 dhe 38 i vendimit*).

14. Mendoj se nëpërmjet këtij gjykimi, Gjykata kishte mundësi dhe e kishte për detyrë të kontrollonte edhe respektimin e vendimit të saj të mëparshëm, nëse Kuvendi e kishte zbatuar apo ishte orientuar prej tij, për arritjen e një qëllimi në përputhje me normën kushtetuese.

15. Mbyllja e gjykimit në kuadrin e kushtetutshmërisë, pa ndërhyrë në atë të diskrecionit që i përket ligjvënësit, kërkon nga ana e Gjykatës një vetëkufizim kategorik të kompetencave të saj në kuptimin që ajo do të duhet të vërë në bazë të vlerësimeve të saj, kritere dhe parime të nxjerrshme objektivisht nga normat kushtetuese, pa ndërhyrë në zgjidhjet e kryera nga ligjvënësi⁹. Çështja se cilët janë mekanizmat e përshtatshëm për të respektuar dispozitat kushtetuese, mbetet kompetencë e ligjvënësit, por gjithsesi kjo nuk duhet ta pengojë Gjykatën Kushtetuese që të rishqyrtojë mekanizmin e përzgjedhur nga ligjvënësi nëse plotëson kriteret dhe qëllimet kushtetuese.

16. Sipas *Martines*, ligjvënësi vepron me ligje të zakonshme, me ligje kushtetuese, dhe ligje për rishikim kushtetues, të cilat ndryshojnë në varësi të procedurës, shumicës së kërkuar dhe objektit të rregullimit ligjor¹⁰. Sipas Kushtetutës sonë, ligjvënësi (kupto: Kuvendi) mund të miratojë ligje me shumicë të thjeshtë (neni 78), ligje me shumicë të cilësuar prej 3/5 (neni 81/2), ndryshime kushtetuese me shumicë të cilësuar prej 2/3 (neni 177¹¹). Rotacioni i anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese me 1/3 e anëtarësisë, ka lidhje me organizimin e Gjykatës Kushtetuese. Çdo lloj rregullimi nga Kuvendi do të prekte domosdoshmërisht dispozitat ligjore dhe kushtetuese, të cilat përcaktojnë organizimin e kësaj gjykate dhe që për rrjedhojë do të duhej të realizohej nga Kuvendi në cilësinë e “ligjvënësit kushtetues”. Në këtë këndvështrim, gjykoj se mekanizmi që Kuvendi mund të përdorte për respektimin e nenit 125/3 të Kushtetutës, nuk mund të ishte një vendim i bazuar në nenin 55 të Rregullores së Kuvendit dhe nenin 78 të Kushtetutës (*shumicë e thjeshtë*). Prandaj, dhe me nxjerrjen e vendimit nr. 106, datë 23.06.2011 “Për miratimin e propozimit të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, për zbatimin e vendimit të GJK nr. 24/2011, për ripërtëritjen e përbërjes së Gjykatës Kushtetuese çdo tre vjet me një të tretën e saj”, Kuvendi nuk ka gjetur *mekanizmin e përshtatshëm* si ligjvënës kushtetues për respektimin e nenit 125/3 të Kushtetutës.

17. Përveç sa më lart, vendimi nr. 106 i Kuvendit nuk është mekanizmi i përshtatshëm, edhe sepse nuk i jep zgjidhje kushtetuese rotacionit të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, por zgjidhje praktike vetëm rastit në fjalë. Interpretimi i nenit 125/3 nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 24/2011, orientonte qartësisht ligjvënësin kushtetues për një zgjidhje afatgjatë, e cila do të duhej të kishte parasysh dhe të mbronte vlerat kushtetuese mbi cilësinë e trupës gjyqësore dhe konsistencën e vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese. Prandaj, edhe për këtë arsye, mekanizmi i gjetur nga Kuvendi i tipit “vendim” ka dalë jashtë kontekstit të interpretimit të nenit 125/3 të Kushtetutës nga Gjykata Kushtetuese.

18. Sipas shumicës, mosshqyrtimi i dekretëve nga ana e Kuvendit ka ardhur si pasojë e interpretimit origjinal që ligjvënësi u ka bërë dispozitave kushtetuese dhe vendimit nr. 24/2011 të GJK-së për të realizuar përtëritjen e përbërjes së saj me një të tretën, çdo tre vjet, në funksion të ruajtjes së vazhdimësisë dhe koherencës në vendimmarrjen e këtij organi kushtetues (*prg. 35 i vendimit*).

19. Mendoj se për nenin 125/3 të Kushtetutës nuk mund të ketë interpretim origjinal/autentik, sepse *së pari*, është realizuar një interpretim teleologjik nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 24/2011, duke nxjerrë në pah qëllimin e normës dhe *së dyti*, nuk mund të konsiderohet interpretim origjinal i organit që ka nxjerrë normën, sepse “organi” në këtë rast do të duhej të ishte “ligjvënësi

⁹ *Cit.*, Martines Temistocle “Diritto Costituzionale”, Giuffrè Editore 2005, f. 464.

¹⁰ *Perifrazim* nga Martines Temistocle “Diritto Costituzionale”, Giuffrè Editore; 2005, (sezione IV, La funzione legislative delle Camere) f. 271-294.

¹¹ Shih për më tepër vendimin nr. 25, datë 24.07.2009 të Gjykatës Kushtetuese, në të cilin analizohet neni 177 i Kushtetutës.

kushtetues”. Termi “ligjvënës kushtetues” nuk është i njëjtë me termin “ligjvënës” dhe shumica e ka anashkaluar këtë dallim mes ligjvënësit dhe ligjvënësit kushtetues (*constituent legislator*), gjatë argumentimit të qëndrimit të saj. Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar në dispozitiv në mënyrë të shprehur kompetencën e “*ligjvënësit kushtetues*” për gjetjen e mekanizmit të përshtatshëm. Jo pa qëllim me vendimin nr. 24/2011 është përdorur termi “ligjvënës kushtetues”, sepse organet e pushtetit legjislativ, ekzekutiv, gjyqësor apo dhe organet e pavarura kushtetuese si Gjykata Kushtetuese e marrin legjitimitetin e tyre demokratik, institucional dhe funksional nga ligjvënësi kushtetues¹².

20. Po në vazhden e argumenteve të qëndrimit tim “kundër”, mendoj se *dhënia e pëlqimit* apo *mospëlqimi* janë alternativat e vetme të Kuvendit për t’u shprehur mbi dekretet e Presidentit përmes votimit, ndërsa *pezullimi* si moment procedural nuk ishte opsion kushtetues në procesin në fjalë. Kjo gjykatë, edhe në jurisprudencën e mëparshme, është shprehur se: “Kuvendi e kontrollon Qeverinë dhe *aktin e Presidentit me mjete demokratike*. (...) Duke mos shqyrtuar dekretet e Presidentit, pra duke mos ushtruar Kuvendi të drejtën dhe detyrën e tij, krijohet një precedent i rrezikshëm për funksionimin e shtetit dhe qeverisjen e vendit”¹³.

21. Përpos sa më lart, dua të evidentoj dhe një fakt tjetër në lidhje me arsyen e qëndrimit në pakicë që ka të bëjë me qëndrueshmërinë e vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese. Kjo gjykatë është detyruar t’i përmbahet mënyrës së interpretimit të dhënë prej saj për një normë të caktuar kushtetuese. Ajo është shprehur në lidhje me rëndësinë e qëndrueshmërisë së jurisprudencës dhe rastet apo arsyet e ndryshimit/mosndryshimit të saj. Sipas GJK-së “Parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në Kushtetutë, nënkupton rregullin e vazhdimësisë së jurisprudencës. Megjithatë, është e pranueshme që jurisprudenca kushtetuese të evoluojë, duke synuar rritjen e standardeve kushtetuese. (...) Në aspektin kushtetues është e palejueshme dhe e pamundur që doktrina kushtetuese zyrtare të interpretohet ose të riinterpretohet në një mënyrë të tillë që të ndryshojë sistemin e vlerave të sanksionuara në Kushtetutë, që të mohojë pajtueshmërinë e tyre, që të reduktojë garancitë mbrojtëse të epërsisë së saj në sistemin juridik, që të mohojë konceptimin e kushtetutës si një akt i vetëm dhe harmonik, që të reduktojë garancitë e të drejtave dhe lirive të individit të sanksionuara në kushtetutë dhe *që të ndryshojë modelin e ndarjes së pushteteve*” (*vendimi nr. 30, datë 17.6.2010*).

22. Shumica ka legjitimuar Kuvendin në nxjerrjen e vendimit nr. 106, duke mbajtur një qëndrim të ndryshëm nga qëndrimi i shprehur me vendimin e mëparshëm nr. 24/2011, për domosdoshmërinë e respektimit nga Kuvendi të kriterit “*mekanizëm i përshtatshëm*” dhe “*ligjvënës kushtetues*” në zbatim të nenit 125/3 të Kushtetutës. Në këto kushte, do të duhej të jepeshin argumente të forta të nevojës së këtij ndryshimi.

23. Në përmbyllje, duke u nisur nga vlerësimet e lartpërmendura, gjykoj se vendimi nr. 106, datë 23.6.2011 i Kuvendit ka krijuar *de facto* efekte juridike të tilla sa e ka penguar Presidentin e Republikës të ushtrojë kompetencat kushtetuese, prandaj jam dhe i mendimit se është krijuar konflikt i kompetencave, i cili duhej zgjidhur nga kjo Gjykatë.

Kryetar
Bashkim Dedja

MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me përfundimin e arritur në këtë çështje dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, çmoj të rëndësishme të dal me mendim pakice.

2. Nëpërmjet arsyetimit të saj, shumica ka konkluduar se Kuvendi, me vendimin e tij nr. 106/2011 për mosshqyrtimin e dekretëve deri në prill 2013, kohë në të cilën duhet të zhvillohet përtëritja

¹²Vendim i Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane, BVerfGE 48, 49, Përmbledhje e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane, Konrad Adenauer, 2010.

¹³ Vendimi nr. 6, datë 18.1.2002 i Gjykatës Kushtetuese.



e radhës, nuk ka pasur për qëllim pengimin e kompetencës së Presidentit për emërimin e anëtarëve të rinj të kësaj Gjykate, gjë të cilën ai e ka realizuar. Për të mbështetur këtë konkluzion, shumica ka vlerësuar të arsyeshme të analizojë dhe të interpretojë disa standarde kushtetuese. Kështu, është analizuar dhe interpretuar neni 125/5 i Kushtetutës, lidhur me detyrimin e qëndrimit në detyrë deri në emërimin e pasardhësit që kjo dispozitë kërkon ndaj gjyqtarit të cilit i ka mbaruar mandati; nenet 125/2 dhe 127 për sa i përket organit që deklaron mbarimin e mandatit dhe kuptimin e termit “vakancë”; neni 125/3 i Kushtetutës dhe vendimi nr. 24/2011 i kësaj Gjykate lidhur me detyrimet që rrjedhin nga ky vendim për Kuvendin dhe Presidentin. Këto standarde janë elemente përbërëse të garancive kushtetuese që gëzon Gjykata dhe kanë një rëndësi të veçantë në funksion të pavarësisë së saj. Nuk pajtohem me kuptimin që shumica u ka dhënë standardeve të mësipërme dhe vlerësimin që ajo ka bërë nëse këto standarde janë respektuar apo jo, sipas fakteve të çështjes. Në vijim, do të parashtrohen argumentet që kundërshtojnë qëndrimet e shumicës për të gjitha çështjet e identifikuara më sipër.

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

3. *Pikësëpari*, shumica, në arsyetimin e saj, nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit të ngritur nga subjekti i interesuar në lidhje me legjitimitimin e kërkuarit.

4. Neni 54/3 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, parashikon se, për mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve, të përcaktuara nga neni 131, shkronja “ç”, e Kushtetutës, kërkesa ngrihet nga subjektet në konflikt ose nga subjektet e cenuara drejtpërdrejt nga konflikti. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se mosmarrëveshja e kompetencës mund të shtrohet në dy plane: njëri plan lidhet me rastin kur objekt i mosmarrëveshjes është ndërhyrja me akt normativ në kompetencat e një organi kushtetues, duke sjellë si pasojë pakësimin ose shtimin e kompetencave të tij, ndërsa plani tjetër është rasti kur konflikti i mirëfilltë i kompetencave lidhet me faktin kur një apo disa organe nxjerrin akte që cenojnë sferën e kompetencave të organit tjetër (*shih vendimet nr. 25/2012 dhe nr. 48/2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Shumica, në rastin konkret, ka çmuar se ndodhet përpara një ngërçi institucional, si rrjedhojë e kuptimit të ndryshëm që iu është dhënë neneve 125/5 dhe 127 të Kushtetutës, si dhe vendimit nr. 24/2011 të Gjykatës nga ana e dy institucioneve të ngarkuara me emërimin e gjyqtarëve kushtetues, përkatësisht Kuvendit dhe Presidentit të Republikës. Për pasojë, ajo e ka parë të nevojshme të ndalet tek interpretimi i këtyre dispozitave kushtetuese dhe vendimit nr. 24/2011 të Gjykatës. Ky lloj arsyetimi i shumicës e transformon objektin e kërkesës nga konflikt kompetencash për emërimin e gjyqtarit kushtetues në një “ngërç institucional”. Shumica nuk i referohet një koncepti kushtetues; termi “ngërç institucional” nuk është nocion kushtetues dhe përdorimi i kësaj terminologjie, nga pikëpamja e standardeve të interpretimit, sjell pasiguri dhe konfuzion në lidhje me përcaktimin e çështjes konkrete të parashtruar për zgjidhje përpara Gjykatës.

6. *Së dyti*, shumica e ka parë të arsyeshme të vlerësojë natyrën juridike të vendimit nr. 106/2011 të Kuvendit. Mendoj se ky lloj vlerësimi, duke mos qenë në funksion të ndonjë argumenti të pjesës arsyetuese, nuk ka qenë i nevojshëm. Në bazë të neni 131/ç të Kushtetutës, dhe ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, Gjykata ka juridiksion të vendosë për mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve, me kusht që mosmarrëveshja të ketë lidhje të drejtpërdrejtë me ushtrimin e veprimtarisë së tyre (neni 54/1 i ligjit të sipërcituar). Gjykata merr në shqyrtim këto mosmarrëveshje kur subjektet përkatëse e kanë konsideruar veten kompetente për të vendosur për çështje konkrete (neni 54/2). Si bazë për fillimin e shqyrtimit të këtyre çështjeve mund të shërbejë çdo lloj akti ligjor e nënligjor, veprim ose mosveprim i organeve të pushteteve, që ka çuar në mosmarrëveshje kompetencash midis tyre (neni 54/4).

7. Në rastin në shqyrtim, janë të pranishëm të gjitha elementet e një mosmarrëveshjeje të kësaj natyre. Konkretisht, Kuvendi, me nxjerrjen e vendimit nr. 106/2011, e ka konsideruar veten kompetent për mosshqyrtimin e dekreteve të Presidentit të Republikës dhe shtyrjen e procesit të emërimit të gjyqtarit kushtetues, deri në një datë të caktuar, pasi, sipas tij, në këtë Gjykatë nuk ka vende vakante për t’u plotësuar. Presidenti i Republikës ka pretenduar se ky vendim i Kuvendit ka cenuar kompetencat e tij kushtetuese, për sa i përket emërimit të gjyqtarit kushtetues dhe ka kërkuar zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje në Gjykatën Kushtetuese. Presidenti i Republikës legjitimohet si subjekt për të vënë në

lëvizje Gjykatën në rastin konkret. Për rrjedhojë, shumica duhet të ishte shprehur qartë për legjitimitimin e kërkesit përpara se të kalonte në analizën e meritës së pretendimeve të tij.

B. Për pretendimin e konfliktit të kompetencave ndërmjet Presidentit dhe Kuvendit

8. Gjykata në jurisprudencën e saj ka ritheksuar se mosmarrëveshja e kompetencës mund të paraqitet si në formën e konfliktit “*normativ*”, kur kompetenca që përbën objektin e mosmarrëveshjes parashikohet në ligje, ashtu edhe në formën e konfliktit “*individual*”, kur institucionet në konflikt nxjerrin aktet përkatëse për zbatimin e një ligji konkret, akt ky që bëhet shkak për mosmarrëveshje. Siç ka nënvizuar edhe shumica, konflikti i kompetencave mund të ekzistojë nëse dy organe/pushtete pretendojnë ushtrimin e të njëjtës kompetencë ose kur asnjëri prej dy organeve/pushteteve nuk merr përsipër ushtrimin e një kompetence (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 22/2010; nr. 12/2008; nr. 20/2007 dhe nr. 29/2006*).

9. Gjykata ka vërejtur se, përveçse në hipotezat e mësipërme, bazuar në doktrinën kushtetuese “*konflikti mund të lindë edhe kur një organ nuk kërkon për vete kompetencën për të përmbushur një akt të caktuar, por pretendon që sjellja mosvepruese e një organi tjetër ose një akt i tij kanë zvogëluar kompetencat e tij ose e kanë penguar në ushtrimin e tyre... Pavarësisht nga shprehja ose jo e kundërshtimeve për përkatësinë e pushtetit, mund të konsiderohet se konflikti është i pranueshëm për t’u gjykuar edhe në rast se, nga ushtrimi abuziv i pushtetit pakësohen ose pengohet ushtrimi i kompetencave që Kushtetuta ia atribuon subjektit ankues*” (shih vendimet nr. 48/2011 dhe nr. 29/2006, të Gjykatës Kushtetuese).

10. Në zbatim të parimit bazë të shtetit të së drejtës, atij të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, kushtetutëbërësi ka përcaktuar për secilin nga organet që përfaqësojnë këto pushtete kompetencat që përputhen/i përgjigjen qëllimit të tij. Për sa kohë këto kompetenca janë të përcaktuara nga normat kushtetuese, është e palejueshme që një organ tjetër t’i marrë ose t’i anashkalojë ato me vullnetin e tij (*shih vendimin nr. 24/2011 të GJK-së*).

11. Për pretendimin lidhur me konfliktin e kompetencave midis Presidentit dhe Kuvendit për emërimin e anëtarëve të rinj të Gjykatës, shumica ka nënvizuar se “nuk ka pasur bashkëpunim institucional siç e kërkon fryma e Kushtetutës dhe jurisprudenca e kësaj Gjykate”. Shumica nuk ka argumentuar fillimisht se pse duhet të vlerësohet, në çështjen konkrete, nëse ka pasur apo jo bashkëpunim midis institucioneve përkatëse. Në këtë aspekt duhet vënë në dukje se vendimi i Kuvendit është marrë mbi bazën e një motivi tjetër dhe jo sepse nuk ka pasur kooperim institucional midis Presidentit të Republikës dhe Kuvendit. Nga ana tjetër, as Kushtetuta dhe as jurisprudenca e Gjykatës nuk përmbajnë një përkufizim të këtij lloji bashkëpunimi apo të kriterëve specifike ku ai mbështetet. Shumica, pa shpjeguar në mënyrë të qartë se çfarë do të kuptohet me bashkëpunim institucional dhe pa e zbërthyer saktësisht në detaje këtë koncept, arrin në përfundimin se nuk ka pasur bashkëpunim. Për më shumë, ajo nuk mbështetet në fakte që vërtetojnë nëse ka pasur apo jo bashkëpunim, fakte këto që do të duhej të administroheshin gjatë procesit të gjykimit kushtetues dhe mbi të cilat palët do të kishin pasur mundësinë të shpreheshin.

12. Në rastin konkret nuk është shtruar çështja nëse ka pasur apo jo bashkëpunim institucional në funksion të përcaktimit të kriterëve ligjore, në përputhje me kërkesën kushtetuese për kualifikim të lartë, për të siguruar një përbërje cilësore të Gjykatës. Procesi i emërimit në çështjen në shqyrtim është në fazën kur Presidenti ka nxjerrë dekretet përkatëse dhe ia ka dërguar Kuvendit për shqyrtim. Në këtë hallkë të procesit të emërimit nuk është thelbësor bashkëpunimi institucional në drejtim të përcaktimit të kriterëve ligjore kualifikuese për kandidatët, i trajtuar në vendimin nr. 24/2011 të Gjykatës, por shprehja e vullnetit/ushtrimi i kompetencave kushtetuese nga ana e Presidentit dhe Kuvendit, brenda afateve procedurale të arsyeshme dhe duke respektuar në mënyrë të ndërsjellë kompetencat e njëri-tjetrit, në përputhje me frymën e Kushtetutës.

13. Pas vendimeve të Gjykatës mbi deklarimin e mbarimit të mandatit për 6 gjyqtarë kushtetues, Presidenti i Republikës ka shprehur vullnetin/ushtruar kompetencën e tij nëpërmjet nxjerrjes së dekretëve të emërimit. Kuvendi ka miratuar 3 prej këtyre dekretëve, ndërsa për 3 të tjerët nuk ka shprehur vullnetin e tij/ushtruar kompetencën për të dhënë ose jo pëlqimin, në përputhje me nenin 125/1 të Kushtetutës, por e ka ndërprerë procedurën e shqyrtimit të tyre deri në prill të vitit 2013. Emërimi i gjyqtarëve të



Gjykatës është një detyrim kushtetues të cilit Kuvendi nuk mund t'i shmanget për arsye se ky proces lidhet drejtpërdrejtë me funksionalitetin e një organi që garanton Kushtetutën, funksionalitet i cili duhet ruajtur në komponentët e tij esenciale të pavarësisë dhe paanshmërisë. Vetëm nëse Kuvendi shpreh vullnetin e tij ndaj dekreteve të Presidentit nëpërmjet votimit brenda një kohe të arsyeshme, respektohet fryma e dispozitës kushtetuese që parashikon vazhdimin në detyrë të gjyqtarit deri në zëvendësimin e tij.

14. Bazuar në jurisprudencën e Gjykatës dhe argumentet e sipërcituara, mosveprimi i Kuvendit në drejtim të shprehjes së vullnetit ndaj dekreteve të Presidentit e ka penguar këtë të fundit në ushtrimin e kompetencës së tij për emërimin e gjyqtarëve kushtetues. Për rrjedhojë, shumica duhet të kishte vendosur zgjidhjen e konfliktit të kompetencave; shfuqizimin e vendimit të Kuvendit dhe detyrimin e këtij të fundit për të vazhduar me shqyrtimin e dekreteve të Presidentit, në përputhje me detyrimin kushtetues që Kuvendi ka për dhënien ose jo të pëlqimit ndaj këtyre dekreteve.

C. Për detyrimin që imponon neni 125/5 i Kushtetutës ndaj gjyqtarit që i ka mbaruar mandati për të qëndruar në detyrë deri në emërimin e pasardhësit

15. Kërkuesi ka pretenduar se vendimi nr. 106/2011 i Kuvendit ka sjellë si pasojë qëndrimin në detyrë tej mandatit kushtetues të tre gjyqtarëve të pazëvendësuar, duke vënë në diskutim legjitimitetin e Gjykatës. Shumica, nisur nga parashikimi kushtetues i nenit 125/5, sipas së cilit gjyqtari kushtetues qëndron në detyrë deri në ardhjen e gjyqtarit të ri, ka arsyetuar se ky rregullim kushtetues detyruet i jep legjitimitetin e nevojshëm Gjykatës, me qëllim vazhdimësinë e drejtësisë kushtetuese, pavarësisht situatave të mundshme që mund të krijohen gjatë procesit të emërimit të gjyqtarëve të rinj.

16. Ky qëndrim i shumicës nuk mbështetet në një interpretim korrekt të dispozitave përkatëse dhe të frymës së Kushtetutës, për arsye se nuk e vendos vlerën e vazhdimësisë së drejtësisë kushtetuese në raport të drejtë dhe në harmoni me parime të tjera kushtetuese, të cilat mund të cenohen nga situata të mundshme të krijuara gjatë procesit të emërimit të gjyqtarëve të rinj. Padyshim, ruajtja e vazhdimësisë së drejtësisë kushtetuese është e rëndësishme, por jo mbizotëruese në raport me ruajtjen e parimeve kushtetuese të pavarësisë dhe paanshmërisë së Gjykatës, të cilat, referuar dokumenteve ndërkombëtare bazë për gjyqësorin¹⁴, janë me rëndësi primare për ekzistencën dhe funksionimin e saj.

17. Pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave është një nga parimet themelore të shtetit demokratik. Roli i gjyqtarit dhe gjykatave në një shtet të tillë është që, ndërsa ata ushtrojnë funksionin e drejtësisë, duhet të sigurojnë zbatimin e normave të shprehura në Kushtetutë, të ligjeve dhe të akteve të tjera ligjore, të garantojnë shtetin e së drejtës dhe të mbrojnë të drejtat dhe liritë e njeriut (*shih vendimin nr. 11/2008 të GJK-së*).

18. Gjykata zë një vend mjaft të rëndësishëm në rendin tonë kushtetues. Vendimet që marrin gjyqtarët kushtetues kanë shpesh efekte rregulluese të një rëndësie të madhe sociale, politike dhe ekonomike për shoqërinë. Për këto arsye, këto kompetenca duhet të ushtrohen nga këta gjyqtarë në mënyrë të ekuilibruar, të pavarur dhe të paanshme. Pavarësia e Gjykatës ka dy dimensione të cilat shkrihen te njëra-tjetra: pavarësinë individuale të gjyqtarëve dhe pavarësinë institucionale të vetë Gjykatës, si organ kushtetues. Nëse nuk garantohet pavarësia individuale është e vetëkuptueshme se kjo ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e paanshmërisë që kërkohet gjatë ushtrimit të funksionit.

19. Besimi i publikut te gjyqtarët kushtetues, si vlerësues neutralë dhe të pavarur të ligjit, është thelbësor për legjitimitetin e Gjykatës, sidomos duke pasur parasysh rolin e saj si garantuese e Kushtetutës dhe shtetit të së drejtës. Nëse ky besim cenohet apo dobësohet, ajo që humbet është diçka shumë më e rëndësishme krahasuar me efektet e zgjidhjes së çështjes konkrete kushtetuese.

20. Në vijim të këtij arsyetimi, mendoj se problemi kryesor që meriton vëmendje të veçantë në rastin konkret është ruajtja e pavarësisë dhe paanshmërisë së Gjykatës. Vazhdimësia e drejtësisë kushtetuese dhe përtëritja, si proces kushtetues, janë në funksion të ruajtjes dhe forcimit të pavarësisë dhe paanshmërisë së Gjykatës. Vetë Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se “me qëllim që të

¹⁴ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut; Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike; Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), Parimet Bazë për Pavarësinë e Gjyqësorit miratuar nga Asambleja e OKB-së; Rekomandimi për Pavarësinë, Efiçencën dhe rolin e gjyqtarëve miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës; Karta Universale e Gjyqtarit etj (*shih pikën 7 të vendimit nr. 11/2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

përcaktohet nëse një organ është “i pavarur”, duhet konsideruar mënyra e emërimit të anëtarëve të tij, si dhe kohëzgjatja e funksionit të tyre” (*shih vendimin nr. 20/2009 të GJK-së*). Ndërhyrja në funksionimin e gjykatave, si instrument i balancës, duhet të rregullohet në mënyrë të tillë që pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave të mos shkelet (*shih vendimin nr. 20/2009 të GJK-së*).

21. Sipas nenit 125/2 të Kushtetutës, gjyqtarët kushtetues emërohen për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi. Kjo dispozitë, duke sanksionuar në mënyrë të qartë një kohëzgjatje të caktuar të mandatit kushtetues, përbën një nga faktorët që garantojnë pavarësinë e Gjykatës. Një mandat kushtetues i parashikuar specifikisht në kohëzgjatje shmang rrezikun e influencës dhe presioneve politike ndaj gjyqtarit, duke qenë se këtij të fundit i garantohet kohëzgjatja dhe paprekshmëria e mandatit. Gjykata, në vendimin nr. 24/2011, ka nënvizuar se: “Vetëm një gjykatë e pavarur, së cilës i garantohet paprekshmëria e mandatit të anëtarëve të saj, mund të konsiderohet si një gjykatë që administron drejtësinë kushtetuese, në përputhje me parimet kushtetuese. Edhe pse mandati i gjyqtarit kushtetues ka kuptimin e një mandati të dhënë (jo të fituar nëpërmjet votës së zgjedhësve aktivë), parimi i pavarësisë nënkupton, gjithashtu, se gjyqtari, në momentin e emërimit, duhet të dijë kohëzgjatjen e këtij mandati, bazuar në rregullimet ligjore përkatëse dhe kjo kohëzgjatje nuk mund të lihet në diskrecion të organeve që e kanë emëruar/zgjedhur atë (...) mbarimi ose ndërprerja e mandatit të një gjyqtari kushtetues, në bazë të vendimit të organit që e ka zgjedhur atë dhe jo sipas një procedure ligjore të përcaktuar, me të cilën gjyqtari është njohur dhe e ka pranuar në momentin e zgjedhjes së tij, është e papajtueshme me parimet kushtetuese”.

22. Rregulli i vazhdimësisë së qëndrimit në detyrë të gjyqtarit kushtetues deri në emërimin e pasardhësit të tij, i parashikuar në nenin 125/5 të Kushtetutës, garanton mbi të gjitha funksionimin normal të Gjykatës. Megjithatë, kjo dispozitë, ashtu si çdo dispozitë e Kushtetutës, duhet të interpretohet në mënyrë që të jetë e pajtueshme me parimet themelore kushtetuese, në lidhje me dispozitat e tjera dhe brenda kontekstit të saj (*shih vendimet 24/2011; 29/2009; 2/2005 të GJK-së*). Rrjedhimisht, në përputhje me frymën e Kushtetutës, qëndrimi në detyrë i gjyqtarit kushtetues deri në emërimin e pasardhësit të tij nënkupton respektimin e tri parakushteve: *së pari*, Presidenti dhe Kuvendi duhet të ushtrojnë vullnetin e tyre nëpërmjet akteve përkatëse, brenda kompetencave që u janë dhënë nga Kushtetuta; *së dyti*, këto organe duhet të veprojnë brenda një kohe të arsyeshme dhe sipas një procedure transparente ku janë të përcaktuara në mënyrë të qartë afatet kohore të domosdoshme për mbylljen normale të procedurës së emërimit të gjyqtarit të ri; dhe *së treti*, vazhdimësia e gjyqtarit në detyrë duhet të kuptohet dhe zbatohet si një vazhdimësi brenda një kohëzgjatjeje të arsyeshme. Një periudhë e gjatë qëndrimi në detyrë pas mbarimit të mandatit, e cila mund të përbëjë konsumim të një pjese substanciale të mandatit të rregullt 9-vjeçar, megjithëse nuk është funksionalisht ekuivalente me një riemërim, juridikisht rrezikon t’i ngajë një riemërimi, në shkelje të nenit 125/2 të Kushtetutës. Shumica shprehet në mënyrë të përgjithshme se, si në rastet e përfundimit para kohe të mandatit të gjyqtarit, ashtu edhe në rastet e përfundimit normal të mandatit, zëvendësimi i tij duhet të bëhet brenda një afati të arsyeshëm, por pa bërë një vlerësim nëse afati i arsyeshëm është respektuar apo jo në rastin konkret.

23. Mekanizmi i emërimit/dhënies së pëlqimit të gjyqtarëve kushtetues i parashikuar nga Kushtetuta, në vetvete, lejon krijimin e rasteve në të cilat kërkesa e nenit 125/3 të Kushtetutës objektivisht bëhet e pamundur për t’u respektuar. Përderisa Kuvendi ka diskrecion, sipas Kushtetutës dhe jurisprudencës kushtetuese, për të vlerësuar jo vetëm plotësimin e kriterëve formale, por edhe meritën e kandidaturave të propozuara nga Presidenti, nuk mund të shmangen raste të tilla. Konkretisht, një situatë e tillë do të krijohet në vitin 2016, vit ky kur do të mbarojnë mandatet e dy gjyqtarëve të tjerë, pasuar nga mbarimi i mandatit të një gjyqtari tjetër në vitin 2017. Duke ndjekur këtë linjë arsyetimi, të njëjtën situatë do të kemi edhe në vitin 2019. Nuk ka dyshim se do të ishte jokushtetuese të legjitimohej Kuvendi për të ndërhyrë në mandatet e gjyqtarëve me synimin për të respektuar përtëritjen e Gjykatës me një të tretën. Procesi i emërimit të gjyqtarit kushtetues është rregulluar nga Kushtetuta në mënyrë të tillë që të kuptohet vazhdimin e procedurës në drejtim të dhënies ose jo të pëlqimit nga Kuvendi dhe jo ndërprerjen e saj. Pikërisht këtë ka pasur parasysh kushtetutëbërësi kur ka parashikuar vazhdimin në detyrë të gjyqtarit kushtetues deri në emërimin e pasardhësit të tij. Nëpërmjet rregullit të vazhdimësisë në detyrë kushtetutëbërësi ka pasur si qëllim të sigurojë mirëfunksionimin e Gjykatës, duke nënkuptuar



veprimin në kohë të Kuvendit dhe vazhdimin e procedurave deri në arritjen e konsensusit/dhënien e pëlqimit, brenda afateve të arsyeshme që presupozon një proces normal emërimi. Në këtë këndvështrim, edhe parashikimi i nenit 82/3 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, sipas të cilit “përtëritja e Gjykatës Kushtetuese pas vitit 2001 do të bëhet sipas mbarimit të mandatit të secilit gjyqtar” e detyron Kuvendin të veprojë pavarësisht situatave që mund të krijohen gjatë procesit të emërimit.

24. Mosveprimi i Kuvendit bie në kundërshtim me standardet kushtetuese të trajtuara më sipër dhe mund të bëhet shkas për krijimin e një ndikimi të papërshtatshëm të gjyqtarët kushtetues.

Ç. *Lidhur me organin që deklaroi mbarimin e mandatit dhe kuptimin e termi “vakancë” nën 125/2 dhe 127*

25. Për sa i përket përkufizimit të koncepteve “vakancë” dhe “përfundimi i mandatit” shumica është shprehur se termi “vakancë” lidhet vetëm me rastet e parashikuara nga neni 127/1 dhe nuk ka të bëjë me përfundimin e mandatit të parashikuar nga neni 125/2. Sipas shumicës, përfundimi i mandatit, si rrjedhojë e plotësimit të afatit të caktuar 9-vjeçar, nuk është i nevojshëm të deklarohet. Me këtë qëndrim shumica ndryshon praktikën e Gjykatës dhe nuk merr parasysh detyrimin kushtetues që ajo ka për të dhënë shpjegime për këtë ndryshim. Është tashmë një praktikë e konsoliduar që mbarimi i mandatit të gjyqtarit kushtetues të deklarohet me vendim të Gjykatës.

26. Me vendimin e tij 106/2011, Kuvendi ka konstatuar mungesë vakance në Gjykatë, ndërkohë që sipas vendimeve të Gjykatës të vitit 2010 është deklaruar mbarimi i mandatit të 6 gjyqtarëve kushtetues, çka përbën një mospërputhje midis vendimit të Kuvendit dhe vendimeve të Gjykatës. Vendimet e Gjykatës që deklarojnë mbarimin e mandateve i vendosin organet kompetente për emërimin e gjyqtarëve përpara detyrimit kushtetues të zëvendësimit të tyre, në ushtrim të kompetencave të tyre të mirëpërcaktuara nga Kushtetuta. Në procedurën e emërimit të gjyqtarëve të Gjykatës përfshihen dy organe kushtetuese: Presidenti i Republikës, i cili shqyrton kandidaturat, dekreton kandidatët e përzgjedhur dhe i paraqet ato për miratim dhe Kuvendi, i cili merr vendimin për dhënien ose jo të pëlqimit për kandidaturat përkatëse të përzgjedhura nga Presidenti.

27. Në arsyetimin e saj shumica nuk shprehet për vendimet që janë marrë nga kjo Gjykatë për deklarimin e mbarimit të mandatit të 6 gjyqtarëve të saj në 2010-ën. Deklarimi i mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues nga Gjykata përbën një garanci për arsye se, nga momenti i deklarimit, zyrtarizohet angazhimi i organeve të ngarkuara me emërimin e gjyqtarëve kushtetues, me qëllim nisjen e procedurës për kryerjen e zëvendësimit brenda një afati të arsyeshëm.

D. *Lidhur me kuptimin dhe detyrimet që rrjedhin nga vendimi nr. 24/2011 i kësaj Gjykate dhe nëse këto detyrime janë respektuar apo jo nga Kuvendi dhe Presidenti*

28. Shumica, nisur nga një këndvështrim formal, ka çmuar se vendimi nr. 106/2011 është marrë nga Kuvendi në referencë të vendimit nr. 24/2011 të Gjykatës, që detyron organet kushtetuese të respektojnë qëndrimin në detyrë të 2/3 të anëtarëve të Gjykatës, si një vlerë kushtetuese. Në këtë mënyrë, shumica nuk e ka vlerësuar në themel aktin e Kuvendit, objekt shqyrtimi në rastin konkret, pra, ajo nuk ka kontrolluar nëse akti i përmbush detyrimet që vetë Gjykata ka vendosur për Kuvendin me vendimin nr. 24/2011. Është detyrë e Gjykatës të vlerësojë nëse ushtrimi i kompetencave të Kuvendit dhe Presidentit ka qenë apo jo në përputhje me përcaktimet kushtetuese dhe jurisprudencën e saj.

29. Gjykata, në vendimin nr. 24/2011, ndër të tjera, është shprehur:

- Është në kompetencë të *ligjvënësit kushtetues* që të gjejë dhe të zbatojë mekanizmin e përshtatshëm për të respektuar parimin kushtetues të përtëritjes së përbërjes së Gjykatës Kushtetuese çdo tre vjet, në një të tretën e saj.

- Me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së vitit 1998, kohëzgjatja e mandatit të gjyqtarëve kushtetues ndryshoi nga 12 vjet në 9 vjet, por parashikimi për përtëritjen e Gjykatës mbeti i pandryshuar (neni 125/3). Sipas dispozitës kalimtare kushtetuese (neni 179/1), e reflektuar edhe në dispozitat kalimtare të ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese (neni 82), mandati i gjyqtarëve të zgjedhur në vitin 1992 mbaronte në vitin 2001 dhe përtëritja e Gjykatës pas vitit 2001 do të bëhej sipas mbarimit të mandatit të secilit gjyqtar.

- Gjyqtari, në momentin e emërimit, duhet të dijë kohëzgjatjen e këtij mandati, bazuar në rregullimet ligjore përkatëse dhe *kjo kohëzgjatje nuk mund të lihet në diskrecion të organeve që e kanë emëruar/zgjedhur atë.*

30. Nisur nga sa më sipër, kërkesat konkrete që janë përcaktuar në këtë vendim të Gjykatës në mënyrë të përmbledhur janë: a) Kuvendit i është lënë detyrë që të ushtrojë pushtetin dhe kompetencën e tij si *ligjvënës kushtetues* për të gjetur dhe zbatuar mekanizmin e përshtatshëm që respekton parimin kushtetues të përtëritjes së përbërjes së Gjykatës Kushtetuese çdo tre vjet në një të tretën e saj; b) ky lloj mekanizmi/rregullimi vlen *vetëm për të ardhmen* dhe jo për mandatet e fituara apo të përfunduara; c) Kuvendi mund të vendosë “pro” ose “kundër” dekreteve, por në asnjë mënyrë *nuk mund të lihet në diskrecion të tij* kohëzgjatja e mandatit të gjyqtarit kushtetues.

31. Bazuar në nenet 7, 81, 83, 84 të Kushtetutës, Kuvendi është padyshim mbajtës i pushtetit ligjvënës, pushtet dhe kompetencë të cilën ai e ushtron nëpërmjet miratimit të ligjeve. Gjithashtu, bazuar në nenet 4/2/3, 116 dhe 177 të Kushtetutës, Kuvendit i është njohur pushteti dhe kompetenca për të qenë ligjvënës kushtetues, pra, për të rishikuar Kushtetutën. Por një pushtet dhe kompetencë të tillë ai duhet ta ushtrojë sipas procedurës së përcaktuar nga neni 177 i Kushtetutës dhe me një kuorum të përbërë prej 2/3 e të gjithë anëtarëve të tij. Vetëm në rastin e rishikimit të Kushtetutës dhe vetëm nëse respektohen parashikimet e nenit 177 të Kushtetutës, Kuvendi mund të ushtrojë pushtetin dhe kompetencën e tij si ligjvënës kushtetues.

32. Është e qartë se në rastin konkret Kuvendi nuk e ka ushtruar kompetencën tij si ligjvënës kushtetues, pasi nuk rezulton të jetë ndërmarrë nga Kuvendi ndonjë nismë në këtë drejtim. Përkundrazi, Kuvendi, me një vendim të marrë me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve të tij, në kundërshtim me çka ka përcaktuar Gjykata në vendimin nr. 24/2011 dhe me nenin 177 të Kushtetutës, e ka konsideruar të përmbushur kompetencën e tij si ligjvënës kushtetues, për sa i përket gjetjes dhe zbatimit të mekanizmit të përshtatshëm për të respektuar përtëritjen e përbërjes së Gjykatës Kushtetuese, çdo tre vjet, në një të tretën e saj. Shumica, duke mos e analizuar dhe anashkaluar mosveprimin e Kuvendit, në lidhje me ushtrimin e kompetencave të tij si ligjvënës kushtetues, e ka legjitimuar këtë mosveprim. Përveç kësaj, duhet theksuar se problemi kushtetues që është shqyrtuar nga Gjykata në vendimin nr. 24/2011, është krijuar nga ndërvarësia, në atë rast, e nenit 125/3 me një dispozitë kalimtare kushtetuese (neni 179). Për arsye të ometimit kushtetues në tekstin e kësaj dispozite kalimtare, Gjykata e ka analizuar procesin e përtëritjes të lidhur me parashikimin e dispozitës kalimtare, duke arritur në përfundimin se i takon ligjvënësit kushtetues të gjejë e të zbatojë mekanizmin e përshtatshëm që është në përputhje me përtëritjen e përbërjes së saj me 1/3. Kuvendi, jo vetëm që nuk e ka ushtruar kompetencën e tij si ligjvënës kushtetues, por, në kundërshtim me vendimin nr. 24/2011 të Gjykatës, ka ndërhyrë në kohëzgjatjen e mandatit të gjyqtarit kushtetues, ndërkohë që në të njëjtin vendim Gjykata është shprehur se nuk është në diskrecion të tij ta bëjë një gjë të tillë.

33. Situata faktike e krijuar në vitin 2010, ku kërkohet përtëritja e Gjykatës me 2/3 e anëtarësisë së saj, siç u trajtua dhe më lart, duhet dalluar nga rastet që mund të krijohen nga vetë dispozita kushtetuese, e cila parashikon mekanizmin e emërimit/dhënies së pëlqimit për gjyqtarin kushtetues, në të cilat kërkesa e nenit 125/3 të Kushtetutës bëhet objektivist e pamundur për t’u respektuar.

34. Duke iu referuar rastit konkret, shumica ka mbajtur qëndrimin se pretendimet mbi përshtatshmërinë e mekanizmit të gjetur nga Kuvendi për të zgjidhur situatën e krijuar shkojnë tej juridiksionit të saj. Nuk pajtohem me këtë linjë arsyetimi të ndjekur nga shumica për arsye se ky interpretim është qartazi i ndryshëm nga ai që ka bërë Gjykata në vendimin nr. 24/2011; në këtë vendim, Gjykata ka evidentuar shprehimisht një zgjidhje *vetëm* nëpërmjet *ligjvënësit kushtetues*, që nënkupton gjetjen e mekanizmit të përshtatshëm me miratimin e 2/3 të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Ky kuorum përbën një garanci shumë të rëndësishme për ruajtjen e stabilitetit dhe pavarësisë së Gjykatës. Për më tepër, nuk duhet të legjitimohet si kushtetuese mundësia e një shumice të thjeshtë parlamentare për të ndërhyrë në mandatet e gjyqtarëve kushtetues duke pasur parasysh se Gjykata, në përmbushje të rolit të saj kushtetues, funksionon edhe si institucion balancues i pushtetit të shumicës parlamentare.

35. Bazuar në vlerësimet e bëra më sipër, ndryshe nga shumica, gjykoj se vendimi nr. 106/2011 i Kuvendit ka penguar ushtrimin e kompetencave të Presidentit për emërimin e gjyqtarëve kushtetues.



Vendimi, objekt shqyrtimi, bie ndesh me jurisprudencën e Gjykatës, sipas së cilës, për sa kohë kompetencat e organeve që përfaqësojnë tri pushtetet janë të përcaktuara nga normat kushtetuese, është e palejueshme që një organ tjetër t'i marrë ose t'i anashkalojë ato me vullnetin e tij (*shih supra par. 10*). Kuvendi ka ndërhyrë në kohëzgjatjen e mandatit të gjyqtarit kushtetues, duke marrë tagra që nuk i lejohen nga Kushtetuta dhe me vullnetin e tij ka anashkaluar kompetencat e tij kushtetuese për dhënien ose jo të pëlqimit ndaj dekreteve të Presidentit të Republikës.

Anëtar: Sokol Berberi

MENDIM PAKICE

Nuk mund të bashkohem me vendimin e shumicës së Gjykatës Kushtetuese, me të cilin është rrëzuar kërkesa e Presidentit të Republikës së Shqipërisë me objekt: 1. Zgjidhjen e konfliktit të kompetencave midis institucionit të Presidentit të Republikës dhe Kuvendit të Shqipërisë; si dhe 2. shfuqizimin e vendimit nr. 106, datë 23.6.2011 të Kuvendit të Shqipërisë.

Arsyet e mospajtitimit tim me këtë vendim të shumicës janë si më poshtë:

1. Siç pranohet dhe në vendim, në datat 28.4.2010 dhe 24.5.2010, Gjykata Kushtetuese ka konstatuar me vendim mbarimin e mandatit të gjashtë gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe këto vendime, në datat 28.4.2010 dhe 25.5.2010, i janë dërguar Presidentit të Republikës për të ndërmarrë procedurat kushtetuese për plotësimin e vendeve vakante. Presidenti i Republikës, në datën 6.9.2010, ka dërguar në Kuvendin e Shqipërisë për pëlqim katër dekrete për emërimet përkatëse. Pas kësaj, një grup deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese për interpretimin e Nenit 125/1/3 të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 24, datë 9.6.2011, lidhur me interpretimin e pikës 3 të nenit 125 të Kushtetutës, në mënyrë të përmbledhur, është shprehur se: “1. *parashikimi i nenit 125/3 ... ka për qëllim ruajtjen në përbërje të Gjykatës Kushtetuese të një shumice prej 2/3 të anëtarëve në detyrë, duke bërë të mundur krijimin e një përvoje juridike të posaçme ...; dhe se 2. gjetja dhe zbatimi i një mekanizmi të përshtatshëm për të respektuar nenin 125/3 të Kushtetutës, është kompetencë e ligjvënësit kushtetues*”.

Mbi propozimin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut të Kuvendit të Shqipërisë, Kuvendi, me vendimin nr. 106, datë 23.6.2011, ka vendosur “*ndërprerjen e procedurave për tri kandidaturat e fundit; këto procedura mund të kryhen vetëm pasi të plotësohet afati trevjeçar nga rotacioni i këtij viti; dekretet t'i kthehen mbrapsht Presidentit të Republikës*”. Me kthimin e dekreteve, Presidenti i Republikës në datën 28.7.2011 i është drejtuar edhe një herë Kuvendit të Shqipërisë, duke shprehur rezervat në këtë drejtim.

2. Më datën 24.10.2011 Presidenti i Republikës, në bazë të neneve 131/ç dhe 134/1/a të Kushtetutës, i është drejtuar me një kërkesë Gjykatës Kushtetuese dhe më pas me një plotësim kërkesë – me objekt: 1. *zgjidhjen e konfliktit të kompetencave ndërmjet institucionit të Presidentit të Republikës dhe të Kuvendit të Shqipërisë; si dhe 2. shfuqizimin e vendimit të mësipërm të Kuvendit të Shqipërisë*.

3. Gjykata Kushtetuese e ka rrëzuar kërkesën e Presidentit të Republikës në të dyja kërkimet e saj.

4. Në opinionin tim kërkesa e mësipërme duhej pranuar në të dyja kërkimet e saj sepse në rastin në shqyrtim përmbushen të gjitha kushtet për të pretenduar një mosmarrëveshje kompetencash midis pushteteve, në kuptim të nenit 131/ç të Kushtetutës. Sipas një praktike të konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese, që të pretendohet një mosmarrëveshje kompetencash, ndërmjet të tjerash, kërkohet që *mosmarrëveshja të lindë ndërmjet organeve që u përkasin pushteteve të ndryshme lidhur me përcaktimin e sferës së kompetencave kushtetuese që u përkasin këtyre pushteteve*. Mosmarrëveshja mund të lindë edhe në një hipotezë tjetër, siç është ajo kur një nga organet kushtetuese pretendon se një organ i një pushteti tjetër, me mosushtrimin e kompetencave të veta kushtetuese, e pengon atë në ushtrimin e kompetencave.

5. Mendoj se, në rastin në shqyrtim, është krijuar një mosmarrëveshje kompetencash në hipotezën e dytë – pra, atë të pengimit në ushtrimin e kompetencave kushtetuese të Presidentit të Republikës. Konkretisht, me krijimin e gjashtë vendeve vakante në Gjykatën Kushtetuese, gjë që është konstatuar me vendimet përkatëse të vitit 2010 të kësaj gjykate, Presidenti i Republikës ka filluar procedurën e plotësimit të këtyre vendeve vakante. Fillimisht janë plotësuar dy vende vakante me nxjerrjen e dekretëve përkatëse dhe duke marrë pëlqimin e Kuvendit të Shqipërisë, dhe më pas, më datë 6.9.2010, Presidenti i Republikës ka nxjerrë katër dekrete të tjerë. Nga këto dekrete, njëri ka marrë pëlqimin e Kuvendit duke plotësuar edhe një vend vakant, ndërsa tri dekretet e tjera i janë kthyer Presidentit, pa u votuar siç kërkon neni 125/1 i Kushtetutës duke dhënë ose jo pëlqimin. Kështu, përderisa formula kushtetuese e emërimit të gjyqtarit përfshin dy autoritete publike, kjo procedurë nuk mund të përmbyllet pa shprehur vullnetin të dyja këto autoritete publike. Për pasojë, Kuvendi i Shqipërisë kishte detyrimin kushtetues të jepte ose refuzonte pëlqimin për dekretet, e jo të zgjidhte një mënyrë jokushtetuese, siç është kthimi pa votimin në meritë/në themel të dekretëve. Pikërisht duke mos ushtruar autoritetin vet kushtetues në njërën nga mënyrat e mësipërme, Kuvendi i Shqipërisë ka bllokuar në mënyrë jokushtetuese procedurën e ndërmarrë nga ana e Presidentit të Republikës për plotësimin e vendeve vakante në Gjykatën Kushtetuese.

6. Këtë mënyrë procedimi për kthimin e dekretëve Presidentit të Republikës, Kuvendi i Shqipërisë e ka argumentuar se është në zbatim të vendimit nr. 24, datë 9.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilit: *1. në bazë të nenit 125/3 ... duhet të ruhet përbërja e Gjykatës Kushtetuese në një shumicë prej 2/3 të anëtarëve në detyrë, ...; dhe se 2. gjetja dhe zbatimi i një mekanizmi të përshtatshëm për të respektuar nenin 125/3 të Kushtetutës, është kompetencë e ligjvënësit kushtetues*. Në interpretim të këtij vendimi të Gjykatës Kushtetuese, Kuvendi me vendimin e kundërshtuar ka vendosur ndërpërprerjen e procedurave për tri kandidaturat e fundit dhe kthimin e dekretëve Presidentit të Republikës, me arsyetimin se në këtë gjykatë nuk ka vende vakante.

7. Siç u shpreha edhe më sipër, unë nuk mund të pajtohem edhe me vendimin nr. 24, datë 9.6.2011 të shumicës së Gjykatës Kushtetuese. Në mendimin tim të mospajimit me këtë vendim jam shprehur se kërkesa e një të pestës së Kuvendit për interpretimin e neneve 125 e 136 të Kushtetutës nuk duhet të pranohej për shqyrtim për mungesë të juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese, sepse, në thelb, kjo ishte një kërkesë për dhënien e një mendimi këshillimor, për të cilin kjo Gjykatë nuk ka juridiksion. Megjithatë, meqë vendimi nr. 24, datë 9.6.2011 përbën bazën e arsyetimit edhe për vendimin e tanishëm të Gjykatës, i cili ka pasur për objekt – zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave midis pushteteve, për të cilin kjo gjykatë aktualisht ka juridiksion, do të arsyetoj mospajtimin me këtë vendim edhe për themelin e çështjes.

8. Objekt i vendimit të mësipërm nr. 24, datë 9.6.2011 ka qenë edhe interpretimi i nenit 125 të Kushtetutës që lidhet me vendimin e tanishëm me objekt – zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave. Në atë vendim është shtruar çështja nëse largimi i më tepër se i një të tretës së anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, siç është rasti në shqyrtim, prek parimin e ripërtëritjes së përbërjes së Gjykatës Kushtetuese në 1/3, çdo tre vjet, të parashikuar në këtë dispozitë. Lidhur me këtë problem, në këtë vendim Gjykata Kushtetuese është shprehur, në mënyrë të përmblodhur se “... si rezultat i parashikimeve të dispozitave kalimtare, në vitin 2010 mbaroi njëkohësisht mandati ... i 6 gjyqtarëve të Gjykatës, duke mos u respektuar urdhërimi kushtetues për ripërtëritjen e Gjykatës çdo tre vjet me një të tretën e saj”. Në përfundim, lidhur me interpretimin e nenit 125/3 të Kushtetutës, Gjykata është shprehur se “parashikimi i nenit 125/3 ... ka për qëllim ruajtjen në përbërje të Gjykatës Kushtetuese të një shumice prej dy të tretave të anëtarëve në detyrë ... dhe se gjetja dhe zbatimi i një mekanizmi të përshtatshëm për të respektuar nenin 125/3 të Kushtetutës është kompetencë e ligjvënësit kushtetues”.

9. Mendoj se interpretimi i mësipërm i nenit 125/3 të Kushtetutës, i cili nënkupton se në të gjitha rastet duhet të ruhet 2/3 e anëtarëve në detyrë, sepse përndryshe prek parimin e ripërtëritjes së përbërjes së Gjykatës Kushtetuese në 1/3 çdo tre vjet, të parashikuar në nenin 125/3 të Kushtetutës, është i gabuar. Në opinionin tim, ripërtëritja e Gjykatës Kushtetuese nuk kryhet vetëm në hipotezën e paragrafit 3 të nenit 125, por edhe në kushtet e hipotezës së paragrafit 2 të nenit 125, pra, kur mbaron mandati i plotë 9-



vjeçar i gjyqtarit, si dhe në hipotezën e nenit 127 kur mbaron në mënyrë të parakohshme mandati i gjyqtarit (në rast dënimi për kryerjen e një krimi; në rast mosparaqitje në detyrë për më tepër se 6 muaj; kur mbush moshën 70 vjeç; kur jep dorëheqjen; si dhe kur deklarohet i paafte për të vepruar). Pra, kur përfundimi i tre vjetëve, kohë kur do të duhet të bëhej ripërtëritja sipas nenit 125/3 të Kushtetutës, përkon me largimin e gjyqtarëve për shkak të mbarimit të plotë të mandatit 9-vjeçar, apo me largimin e gjyqtarëve për rastet e mbarimit të parakohshëm, si dhe me një largim të gjyqtarëve në kombinim të këtyre të dy hipotezave, atëherë edhe ky largim përbën një “ripërtëritje të përbërjes së Gjykatës Kushtetuese”. Mirëpo kjo ripërtëritje që kryhet sipas paragrafit 2 të nenit 125 dhe nenit 127, në dallim nga ajo paragrafit 3 të nenit 125, nuk kushtëzohet me ripërtëritjen në 1/3 që përcakton kjo dispozitë. Kjo sepse ripërtëritja vetëm në masën 1/3 sipas 125/3 zbatohet vetëm kur mbarimi i periudhës 3-vjeçare nuk përkon me largimin e më shumë se 1/3 së gjyqtarëve për shkak të mbarimit të plotë të mandatit 9-vjeçar (neni 125/2), apo të largimit për shkak të mbarimit të parakohshëm të mandatit (neni 127). Në këto raste, ripërtëritja mund të jetë në një masë më të madhe se ajo e kërkuar nga paragrafi 3 i nenit 125. Në rast se do të interpretohej ndryshe paragrafi 3 i nenit 125 (siç e ka interpretuar shumica), kjo do të vinte në kundërshtim me paragrafin e dytë të po këtij neni, sipas të cilit *gjyqtarët emërohen për 9 vjet*. Pra, në qoftë se do të pranohej konkluzioni i shumicës se paragrafi 3 i nenit 125 ndalon ripërtëritjen e më shumë se 1/3 edhe në rastin e mbarimit të plotë apo të mbarimit të parakohshëm të mandatit, kjo do të çonte në zgjatjen e mandatit tej atij 9-vjeçar të gjyqtarëve (paragrafi 2 i nenit 125), apo do t’u zgjatej mandati dhe do të detyroheshin të qëndronin në detyrë edhe ata gjyqtarë të cilëve u ka mbaruar mandati në mënyrë të parakohshme (neni 127). Për pasojë, në opinionin tim, ripërtëritja vetëm në 1/3 aplikohet vetëm kur në përfundim të një periudhe 3-vjeçare nuk ka mbarim të mandatit në një masë më shumë se 1/3 e përbërjes së Gjykatës, sipas nenit 125/2 e 127 të Kushtetutës. Ndërsa, në rast se sipas dispozitave të mësipërme, largohen më pak se 1/3 e gjyqtarëve atëherë, sipas paragrafit 3 të nenit 125, do të largohen aq gjyqtarë sa në total, bashkë me mbarimin sipas paragrafit 2 të nenit 125 dhe nenit 127, të arrihet në ripërtëritjen në 1/3 e përbërjes së Gjykatës Kushtetuese. Kjo do të thotë se paragrafi 3 i nenit 125 përcakton maksimumin e ripërtëritjes në 1/3 e përbërjes së gjykatës çdo tre vjet, vetëm kur mbarimi i periudhës 3-vjeçare nuk përkon me mbarimin e më shumë se 1/3 së gjyqtarëve, sipas paragrafit 2 të nenit 125 apo nenit 127. Për pasojë, paragrafi 3 i nenit 125 nuk e pengon ripërtëritjen në më shumë se 1/3 e përbërjes së gjykatës, në kushtet e përshkruara më sipër të mbarimit të mandatit sipas paragrafit 2 të nenit 125 apo nenit 127 të Kushtetutës.

Për sa sipër, mund të konkludoj se që në vitin 2010, me mbarimin e mandatit të 6 gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (nga të cilët 5 gjyqtarë kanë konsumuar mandatin e plotë 9-vjeçar) në këtë gjykatë janë krijuar 6 vende vakante, gjë që është konstatuar edhe me vendimet përkatëse të kësaj gjykatë. Në këto kushte, Presidenti i Republikës për plotësimin e këtyre vendeve vakante ka nxjerrë dekretet përkatëse, për tri nga të cilat, siç u përmend edhe më sipër, është dhënë edhe pëlqimi nga ana e Kuvendit të Shqipërisë, duke u përmbyllur kështu procedura e emërimit, ndërsa tri dekrete janë kthyer nga ana e Kuvendit të Shqipërisë me arsyetimin se nuk ka vende vakante në këtë gjykatë.

10. Për këto arsye, unë nuk mund të bashkohem me konkluzionin e Kuvendit të Shqipërisë se deri në vitin 2013 në Gjykatën Kushtetuese nuk ka vende vakante, konkluzion të cilin e ka mbështetur dhe shumica e Gjykatës Kushtetuese. Së pari, në opinionin tim, me mbarimin e mandatit të 6 gjyqtarëve, në këtë gjykatë janë krijuar 6 vende vakante. Këtë fakt e ka konstatuar edhe vetë kjo gjykatë me vendimet përkatëse (*shih vendimet nr. 2, datë 12.1.2007; nr. 3, datë 12.1.2007; nr. 4, datë 12.1.2007; nr. 29, datë 29.12.2008; nr. 10, datë 2.4.2010; nr. 19, datë 28.4.2010; nr. 20, datë 28.4.2010; nr. 24, datë 24.5.2010; nr. 25, datë 24.5.2010; nr. 26, datë 24.5.2010*). Shumica ka arritur në këtë konkluzion për shkak të interpretimit të gabuar nga ana e saj të paragrafit të tretë të nenit 125 të Kushtetutës, se përbërja e gjykatës në asnjë rast nuk mund të përtërihet në më tepër se 1/3. Ky konkluzion do të çonte në atë që megjithëse gjyqtarëve u ka mbaruar afati i qëndrimit në detyrë, për hir të ruajtjes së 2/3 të përbërjes së gjykatës, duhet të qëndrojnë në detyrë dhe për tre vjet të tjera edhe pas përfundimit të mandatit, gjë që shkakton zgjatjen e mandatit të gjyqtarëve në mënyrë jokushtetuese.

11. Gjithashtu, shumica në vendimin e saj, është shprehur se kjo gjykatë është e detyruar të deklarojë me vendim vetëm rastet e përfundimit të mandatit sipas nenit 127/1 të Kushtetutës. Në fakt ky

qëndrim është në kundërshtim me jurisprudencën e konsoliduar të gjykatës në këtë drejtim. Kështu, janë një sërë vendimesh të Gjykatës Kushtetuese, me të cilat, siç përmendëm, kjo gjykatë ka konstatuar mbarimin e mandatit (*shih vendimet nr. 2, datë 12.1.2007; nr. 3, datë 12.1.2007; nr. 4, datë 12.1.2007; nr. 29, datë 29.12.2008; nr. 10, datë 2.4.2010; nr. 19, datë 28.4.2010; nr. 20, datë 28.4.2010; nr. 24, datë 24.5.2010; nr. 25, datë 24.5.2010; nr. 26, datë 24.5.2010*), pa bërë dallimin nëse është mbarim i mandatit të plotë, mbarim i parakohshëm i mandatit apo mbarim i mandatit zëvendësues (nenet 125/2, 127 të Kushtetutës). Për rrjedhojë, mendoj se me këtë vendim Gjykata Kushtetuese ka ndryshuar praktikën/jurisprudencën e saj të deritanishme lidhur me çështjen se cili organ e konstaton vakancën në Gjykatën Kushtetuese. Sigurisht, Gjykata Kushtetuese ka të drejtë të ndryshojë jurisprudencën e saj, por parimi i shtetit të së drejtës (neni 4 i Kushtetutës) i kërkon të sigurohet vazhdimësia e jurisprudencës kushtetuese, dhe për pasojë parashikueshmëria e vendimeve të saj. Kjo nënkupton që ndryshimi i kësaj jurisprudence të krijuar nga Gjykata nëpërmjet vendimeve të saj, mund të bëhet vetëm kur është e nevojshme, si dhe në aspektin kushtetues, të jetë e mbështetur dhe e arsyetuar. Për pasojë, ndryshimi i jurisprudencës kushtetuese nuk mund të bëhet mbi bazën e faktorëve të rastit. Për shembull, ndryshimi apo korrigjimi i jurisprudencës kushtetuese nuk mund të bëhet vetëm për shkak të ndryshimit në përbërjen e Gjykatës Kushtetuese. Ndryshimi i jurisprudencës kushtetuese mund të diktohet vetëm nga rrethanat, si nevojë për të mbrojtur më mirë vlerat kushtetuese për të rritur mundësitë e kontrollit kushtetues në vend, me qëllim që të garantohet drejtësia kushtetuese etj. Një qëndrim të tillë ka mbajtur edhe Gjykata Kushtetuese e Lituaniës lidhur me çështjen e mundësisë së ndryshimit apo modifikimit të jurisprudencës kushtetuese (*shih vendimin datë 28 mars 2006*).

Në rastin në shqyrtim, me vendimin e sipërpërmendur, Gjykata Kushtetuese, megjithëse ka ndryshuar jurisprudencën e saj në këtë drejtim, nuk e ka bërë të njohur këtë fakt. Përveç kësaj, gjykata nuk ka arsyetuar lidhur me këtë ndryshim të jurisprudencës së saj, duke vënë kështu në dyshim parashikueshmërinë e vendimeve të saj, gjë që vjen në kundërshtim me parimin e shtetit të së drejtës (neni 4 i Kushtetutës).

12. Lidhur me urdhërimin e Gjykatës Kushtetuese në vendimin e saj nr. 24, datë 9.6.2011 për zbatimin e një mekanizmi të përshtatshëm për të respektuar nenin 125/3 të Kushtetutës mendoj se Kuvendi i Shqipërisë e ka interpretuar jo saktë këtë vendim. Për pasojë, duke ia kthyer dekretet Presidentit të Republikës pa i shqyrtuar, Kuvendi i Shqipërisë ka proceduar në mënyrë jokushtetuese, duke e penguar Presidentin në ushtrimin e funksionit të tij kushtetues për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

13. Siç kemi parashtruar, në vendimin e mësipërm nr. 24, datë 9.6.2011, Gjykata Kushtetuese, në mënyrë të përmbledhur, është shprehur se: *1. parashikimi i nenit 125/3 ... ka për qëllim ruajtjen në përbërje të Gjykatës Kushtetuese të një shumice prej 2/3 të anëtarëve në detyrë, ...; dhe se 2. gjetja dhe zbatimi i një mekanizmi të përshtatshëm për të respektuar nenin 125/3 të Kushtetutës, është kompetencë e ligjvënës kushtetues.*

Në opinionin tim, siç u arsyetua edhe më sipër, kuadri aktual kushtetues nuk pengon largimin e më shumë se 1/3 të gjyqtarëve në rastet e mbarimit të mandatit sipas neneve 125/2 e 127 të Kushtetutës. Kjo do të thotë se, mbarimi i menjëhershëm i mandatit për 6 gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, jo në kushtet e nenit 125/3 të Kushtetutës, nuk krijon ndonjë situatë jokushtetuese. Për pasojë, nuk lind ndonjë nevojë që *ligjvënësi kushtetues të zbatojë ndonjë mekanizëm për të respektuar nenin 125/3 të Kushtetutës.*

Megjithatë, mendoj se ruajtja e një përbërjeje të Gjykatës prej 2/3 të anëtarëve që kërkon vendimi i mësipërm i Gjykatës Kushtetuese, nuk mund të zgjidhej nëpërmjet amendamentit kushtetues sepse ky amendament nuk mund të aplikohet për përbërjen aktuale të gjykatës duke i dhënë fuqi prapavepruese. Një gjë e tillë do të vinte në kundërshtim me parimin e shtetit të së drejtës (neni 4 i Kushtetutës), të cilit i nënshtrohet edhe procesi i amendimit të Kushtetutës. Edhe në qoftë se do të kishte vend për bërjen e ndonjë amendamenti kushtetues, ky do të aplikohet vetëm për të ardhmen dhe nuk mund të ndërhynte në mandatet e përbërjes aktuale të Gjykatës Kushtetuese.

Përveç sa më sipër, në rastin konkret, duke nxjerrë vendimin e kundërshtuar, Kuvendi ka vepruar si ligjvënës i zakonshëm e jo si ligjvënës kushtetues, pra si pushtet konstituent/kushtetutëbërës. Dhe si pushtet konstituent Kuvendi vepron ose kur miraton një Kushtetutë të re, ose kur



amendon/rishikon kushtetutën ekzistuese, sipas procedurës së rishikimit/amendimit të Kushtetutës (neni 177 i Kushtetutës). Në rastin në shqyrtim, duke marrë vendimin nr. 106, datë 23.6.2011, Kuvendi i Shqipërisë ka vepruar jo si ligjvënës kushtetues, por si ligjvënës i zakonshëm, pra në kundërshtim edhe me vendimin nr. 24, datë 9.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese.

14. Presidenti i Republikës në kërkesën e tij ka pretenduar gjithashtu se vendimi nr. 106, datë 23.6.2011 i Kuvendit të Shqipërisë ka vënë në dyshim legjitimitetin e Gjykatës Kushtetuese për sa i përket vazhdimin të qëndrimit në detyrë të tre anëtarëve të saj deri në prill 2013, pra edhe tri vite të tjera tej mandatit të tyre kushtetues. Lidhur me këtë pretendim të Presidentit të Republikës, shumica e gjykatës, në vendimin e saj, në mënyrë të përmbledhur, është shprehur se *“pretendimi i kërkuarit lidhur me mungesën e legjitimitetit të saj për shkak të qëndrimit në detyrë tej afatit 9-vjeçar të tre anëtarëve është i pabazuar dhe nuk duhet pranuar; se bazuar në nenin 125/5 të Kushtetutës, gjyqtari kushtetues qëndron në detyrë deri në ardhjen e gjyqtarit të ri; dhe se ky rregullim kushtetues i jep legjitimitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm gjyqtarit kushtetues dhe vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese në tërësi”*.

Në opinionin tim ky arsyetim është i gabuar dhe pretendimi i Presidentit të Republikës është trajtuar pa iu referuar ndonjë standardi konkret kushtetues.

Së pari, megjithëse pala kërkuese ka përdorur një terminologji të përgjithshme, duke u shprehur se zgjatja jokushtetuese e mandatit të gjyqtarëve cenon legjitimitetin e Gjykatës Kushtetuese, mendoj se ky pretendim duhet të ekzaminohej në kuadrin e standardit kushtetues për një *gjykatë të caktuar me ligj* (neni 42 i Kushtetutës).

Sipas jurisprudencës kushtetuese, shprehja *gjykatë e caktuar me ligj* mbulon jo vetëm bazën ligjore për vetë ekzistencën e gjykatës, por edhe përbërjen e trupit gjykues në çdo rast/çështje konkret/e. Përveç kësaj, një gjykatë e caktuar me ligj duhet të plotësojë një sërë kushtesh si pavarësia e anëtarëve, *afati i qëndrimit të tyre në detyrë*, paanshmërinë, si dhe ekzistencën e garancive procedurale. Një qëndrim të tillë ka mbajtur edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila i ka konsideruar si shkelje të standardit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj rastet kur nuk janë respektuar afatet e qëndrimit në detyrë të gjyqtarëve (*shih vendimet e GJEDNJ-së Gurov v. Moldova, aplikimi nr. 36455/02; Posokhov v. Russia, aplikimi nr. 63486/00; Fedotova v. Russia, aplikimi nr. 73225/01; DMD GROUP, A.S. v. Slovakia, aplikimi nr. 19334/03*).

Në rastin në shqyrtim mendoj se është shkelur standardi kushtetues për një gjykatë të caktuar me ligj, sepse Kuvendi ka zgjatur në mënyrë jokushtetuese mandatin e tre gjyqtarëve të kësaj gjykate.

Kjo zgjatje e mandatit nuk mund të mbështetet në paragrafin 5 të nenit 125 të Kushtetutës, sepse kjo dispozitë nuk rregullon ndonjë zgjatje të mandatit të gjyqtarit në atë kuptim që i ka dhënë Kuvendi dhe shumica e gjykatës, e aq më tepër një zgjatje fikse prej 3 vjetësh, siç ka ndodhur në rastin në shqyrtim. Kjo dispozitë, për të siguruar funksionimin normal të Gjykatës Kushtetuese në përbërje të plotë të saj, lejon qëndrimin në detyrë të gjyqtarit që i ka mbaruar mandati deri në ardhjen e zëvendësuesit. Lidhur me atë se për sa kohë mund të qëndrojë në detyrë gjyqtari që i ka përfunduar mandatin, mendoj se paragrafi 5 i nenit 125 duhet të interpretohet në lidhje të ngushtë me paragrafin 2 të po këtij neni. Për pasojë, ky vazhdim në detyrë i gjyqtarit që i ka mbaruar mandatin nuk mund të përbëjë një konsumim të një pjese substanciale të një mandati të dytë të gjyqtarit sepse një gjë e tillë vjen në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 125 të Kushtetutës. Vazhdimi në detyrë, ashtu siç pranohet edhe shumica në vendimin e saj, mund të jetë vetëm për një periudhë të arsyeshme kohe sa të përmbillet procedura e emërimit të gjyqtarit pasardhës. Për më tepër, as subjekti i interesuar, Kuvendi i Shqipërisë e as shumica e Gjykatës nuk e kanë lidhur qëndrimin në detyrë të tre gjyqtarëve me emërimin e zëvendësuesve siç kërkon paragrafi 5 i nenit 125, por me ruajtjen e përbërjes prej 2/3 të Gjykatës. Për pasojë, paragrafi 5 i kësaj dispozite në mënyrë të gabuar është përdorur si bazë normative për të justifikuar zgjatjen e mandatit të tre gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese edhe për tre vite të tjera.

15. Në vendim shumica është shprehur gjithashtu se *“Kuvendi ka arritur në përfundimin se shqyrtimi në themel i dekreteve nuk mund të bëhet pasi aktualisht nuk ka vende vakante në këtë gjykatë, dhe se, mosshqyrtimi i dekreteve nga ana e Kuvendit ka ardhur si pasojë e interpretimit origjinal që ligjvënësi u ka bërë dispozitave kushtetuese, si dhe vendimit nr. 24/2011 të kësaj Gjykate...”*.

Mendoj se ekzistenca ose jo e vendeve vakante në gjykatë është kusht për të iniciuar ose jo procedurën e emërimit të gjyqtarëve. Për pasojë, në kuadrin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes së kompetencave midis Presidentit dhe Kuvendit, shumica kishte detyrimin të vlerësonte nëse qëndron përfundimi i Kuvendit se nuk ka vende vakante. Kjo, për arsye se Presidenti ka pretenduar se Kuvendi e ka penguar në ushtrimin e kompetencave të veta për emërimin e gjyqtarëve. Shumica e Gjykatës Kushtetuese nuk mund ta marrë të mirëqenë përfundimin e Kuvendit sepse sipas nenit 124 të Kushtetutës, pasi e kanë interpretuar Kushtetutën aktorë të tjerë kushtetues, në kuadrin e ushtrimit të funksioneve të tyre kushtetuese, dhe kanë divergjenca për këtë interpretim, kjo Gjykatë është interpretuesja përfundimtare e tekstit të saj.

Në rastin në shqyrtim, Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se në gjykatë ka vende vakante, dhe mbi këtë bazë Presidenti ka bërë emërimet përkatëse. Më pas Kuvendi shprehet se në gjykatë nuk ka vende vakante dhe, për pasojë, ia kthen dekretet Presidentit pa i shqyrtuar në themel. Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese, me qëllim që të zgjidhte konfliktin e kompetencave, duhet të shprehej nëse në gjykatë ka apo jo vende vakante. Shumica në vendim nuk e ka bërë këtë, por është mjaftuar duke u shprehur se *mosshqyrtimi i dekreteve nga ana e Kuvendit ka ardhur si pasojë e interpretimit origjinal që ligjvënësi u ka bërë dispozitave kushtetuese dhe vendimit nr. 24/2011*. Një qëndrim i tillë i shumicës është jokushtetues sepse interpretimet e tekstit të kushtetutës nga aktorët e tjerë kushtetues janë të kontrollueshëm nga Gjykata Kushtetuese. Një qëndrim i kundërt do të mohonte funksionin e Gjykatës Kushtetuese si garantuese e respektimit të Kushtetutës dhe interpretuese përfundimtare e saj (neni 124 i Kushtetutës).

16. Shumica është shprehur gjithashtu se *“situata e krijuar ... nuk është nga ato që mund të gjejë zgjidhje (nëpërmjet procedurës) së mosmarrëveshjes së kompetencës midis organeve; se gjykata e pranon se ekziston një situatë jo e zakonshme që ka ardhur si pasojë e një dispozite kalimtare dhe e ligjit nr. 8577/2000, për zgjidhjen e së cilës Gjykata ka përcaktuar organet përgjegjëse duke theksuar mungesën e kompetencës së saj për të plotësuar mangësitë në legjislacion apo për të sugjeruar mekanizmin më të mirë për zgjidhjen e saj”*.

Mendoj se arsyetimi i mësipërm i shumicës është i gabuar.

Së pari, në kushtet kur dy aktorë kushtetues si Presidenti dhe Kuvendi kanë pikëpamje të ndryshme juridike lidhur me atë nëse mund të ripërtërihet më tepër se 1/3 e gjykatës kur krijohen vende vakante për shkak të mbarimit të mandatit të plotë të gjyqtarëve, është Gjykata Kushtetuese e cila, në bazë të nenit 131/ç të Kushtetutës, ka juridiksion të zgjidhë këtë mosmarrëveshje të kompetencave. Dhe rasti në shqyrtim është një rast tipik i një mosmarrëveshjeje kompetencash për të cilat kjo Gjykatë ka detyrimin të investohet, sepse në rast të kundërt nuk do të kryente funksionin e saj kushtetues.

Së dyti, nuk mund të bashkohem edhe me arsyetimin se situata që shumica e quan jo të zakonshme ka ardhur si pasojë e një dispozite kalimtare dhe e ligjit nr. 8577/2000, për zgjidhjen e së cilës Gjykata ka përcaktuar organet përgjegjëse duke theksuar mungesën e kompetencës së saj për të plotësuar mangësitë në legjislacion apo për të sugjeruar mekanizmin më të mirë për zgjidhjen e saj.

Kështu, është e vërtetë se neni 179/1 i Kushtetutës parashikon se *mandati i organeve kushtetuese që do të ekzistojnë me hyrjen në fuqi të kësaj Kushtetute mbaron me afatet e parashikuara në ligjin nr. 7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”*.

Në gjykimin tim kjo do të thotë se gjyqtarët kushtetues që janë zgjedhur para hyrjes në fuqi të Kushtetutës së vitit 1998 janë zgjedhur për një mandat 12-vjeçar e jo 9-vjeçar siç parashikon Kushtetuta e vitit 1998. Megjithatë, edhe këtyre gjyqtarëve me mandat 12-vjeçar, për efekt të ripërtëritjes në aplikim të nenit 125/3 të Kushtetutës, mund t’u ndërpritej mandati ashtu siç u ndërpritet gjyqtarëve që me Kushtetutën e vitit 1998 kanë fituar një mandat 9-vjeçar.

Për pasojë, mendoj se dispozita kushtetuese kalimtare (neni 179/1) nuk krijon problem lidhur me ripërtëritjen dhe nuk ndalon një ripërtëritje në më shumë se 1/3 e gjyqtarëve në rastin kur nga gjykata largohen më shumë se 3 gjyqtarë për shkak të mbarimit të mandatit të plotë apo të parakohshëm të tyre.

Mendoj se edhe ligji nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” nuk krijon ndonjë problem lidhur me përtëritjen e gjykatës. Megjithatë, edhe në qoftë se Gjykata do të konstatonte se ky ligj ishte në kundërshtim me kuadrin kushtetues, duhet ta shfuqizonte atë si çdo ligj



tjetër në ushtrim të juridiksionit të saj.

17. Shumica në vendimin e saj, pasi ka cituar fillimisht vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2005, ku përshkruhen karakteristikat kryesore të procedurës së emërimit të gjyqtarëve, është shprehur se *bashkëpunimi* (midis Presidentit dhe Kuvendit në procesin e emërimit të gjyqtarëve) *mund të realizohet ... duke filluar që në momentin e përzgjedhjes paraprake të kandidaturave ...*

Në këtë drejtim mendoj se shumica ka keqinterpretuar vendimin e sipërcituar të Gjykatës Kushtetuese.

Kështu, në vendimin nr. 2/2005, në mënyrë të përmbledhur, Gjykata Kushtetuese është shprehur se *“sistemi i emërimit i pranuar nga Kushtetuta e Shqipërisë ka në esencë kooperimin institucional të Presidentit të Republikës dhe të Kuvendit të Shqipërisë; se Kuvendi ka kompetencë për shqyrtimin edhe në këndvështrimin e meritës të zgjedhjes së bërë nga Presidenti, se ky sistem emërimi i vë subjektet që përfshihen në të para kërkesës së respektimit të parimit të luajalitetit kushtetues, i cili shpreh në thelb respektin e ndërsjellë nga secili subjekt ndaj kompetencave të tjetrit, si dhe nënkupton krijimin e një raporti bashkëpunimi midis tyre, dhe se ky parim kërkon nga Presidenti i Republikës dhe Kuvendi i Shqipërisë që në zgjedhjen e çdo gjyqtari të udhëhiqen nga i njëjti objektiv – sigurimi i një përbërjeje cilësore dhe të përshtatshme të gjykatave”*.

Siç shihet, në vendimin e saj Gjykata Kushtetuese, në mënyrë lakonike, ka parashtuar karakteristikat kryesore të procesit kushtetues të emërimit të gjyqtarëve dhe të rolit të secilit prej autoriteteve kushtetuese që marrin pjesë në të, por pa u futur në detaje.

Nga qëndrimi i Gjykatës Kushtetuese i shprehur më sipër, del në pah se ndarja e kompetencës së emërimit të gjyqtarëve ka për qëllim evitimin e dukjes së varësisë së Gjykatës vetëm në një autoritet kushtetues dhe se prania në të njëjtin organizëm e gjyqtarëve të cilët emërohen nga autoritete të ndryshme është një garanci e pavarësisë dhe neutralitetit të vetë këtij organizmi. Pra, sipas këtij modeli të procedurës së emërimit të gjyqtarëve, Presidenti i Republikës ka ekskluzivitetin e përzgjedhjes së gjyqtarëve, dhe, për ta balancuar këtë ekskluzivitet, Kuvendi i Shqipërisë ka kompetencën e vetos ndaj kësaj përzgjedhjeje.

Është e vërtetë se pjesëmarrja në procesin e emërimit të Presidentit dhe Kuvendit është karakterizuar si kooperim, por ky është një kooperim i nënkuptuar dhe nuk do të thotë se Kuvendi ka kompetencë të ndërhyjë paraprakisht në zgjedhjet e bëra nga Presidenti, sepse kompetenca e dhënies së pëlqimit nënkupton edhe pushtetin e mosdhënies së pëlqimit.

Siç janë shprehur edhe ekspertët e Komisionit të Venecias, raporti i të cilëve ka shërbyer si bazë për Opinionin *Amicus Curiae* të këtij Komisioni dhënë Gjykatës Kushtetuese, që kjo procedurë e emërimit të funksionojë është e domosdoshme që Presidenti i Republikës të vijë në dijeni të kritereve që aplikon Kuvendi kur shqyrton emërimet e Presidentit dhe se kjo mund të arrihet në rast se Kuvendi i kushton një debat publik ekzaminimit të emërimeve të Presidentit – në një komision të veçantë ose në seancë.

Për sa më sipër, mendoj se arsyetimi i shumicës së bashkëpunimi (midis Presidentit dhe Kuvendit në procesin e emërimit të gjyqtarëve) mund të realizohet ... duke filluar që në momentin e përzgjedhjes paraprake të kandidaturave, është i gabuar.

18. Në vendim shumica arsyeton më tej se *pretendimet lidhur me përshtatshmërinë e mekanizmit të gjetur prej Kuvendit për të zgjidhur këtë situatë të krijuar dhe njëkohësisht për të realizuar ripërtëritjen me një të tretën për çdo tre vjet, shkojnë tej juridiksionit të saj*.

Megjithëse më sipër u shpreha se Kushtetuta dhe ligji Për Gjykatën Kushtetuese nuk kanë nevojë për ndonjë amendim për sa i përket procesit të emërimeve dhe përtëritjes së Gjykatës Kushtetuese, mendoj se pretendimi i përshtatshmërisë së mekanizmit të gjetur nga Kuvendi shtron çështjen e hierarkisë së burimeve të së drejtës, respektimi i së cilës është në juridiksionin kushtetues.

Kështu, në vendimin nr. 24/2011 Gjykata Kushtetuese është shprehur se *gjetja dhe zbatimi i një mekanizmi të përshtatshëm për të respektuar nenin 125/3 të Kushtetutës, është kompetencë e ligjvënës kushtetues*. Siç shihet, Gjykata Kushtetuese i ka kërkuar Kuvendit që në këtë rast duhet të veprojë si ligjvënës kushtetues, pra të nxjerrë një amendament kushtetues, e jo akte me fuqi juridike më të ulët, si ligjet apo vendimet. Në këtë mënyrë, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se çështja përkatëse duhet të

rregullohet vetëm me amendament kushtetues e jo me norma të një rangu më të ulët në hierarkinë e normave. Duke qenë kështu, në qoftë se zgjedh ta rregullojë çështjen që i ka sugjeruar Gjykata Kushtetuese, Kuvendi nuk ka diskrecion të zgjedhë në hierarkinë e akteve normative.

Në këto kushte, mendoj se pretendimi për përshtatshmërinë e mekanizmit të gjetur nga ana e Kuvendit të Shqipërisë në rastin konkret përfshihet në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

19. Shumica arsyeton gjithashtu se *arsyeja pse Kuvendi ka rolin kryesor për zgjidhjen e situatës ku ndodhet sot kjo Gjykatë është fakti se ai është i vetmi organ që përfaqëson drejtpërdrejt vullnetin demokratik të shumicës së zgjedhësve dhe, në këtë kontekst, ka detyrimin dhe përgjegjësinë për të rregulluar një situatë ngërçi.*

Mendoj se arsyetimi i mësipërm nuk është në pajtim me modelin aktual kushtetues të ndërtimit të shtetit, të pozitës së organeve në shtet, si dhe të raporteve midis këtyre organeve. Sipas këtij modeli kushtetues, që u bë i mundur si pasojë e ndryshimeve politike që filluan në vendin tonë pas 1990-ës, parlamenti nuk është më organi suprem i autoritetit të shtetit. Kështu, sipas këtij modeli kushtetues, themeli i shtetit demokratik të së drejtës është *supremacia e Kushtetutës*. Ky parim i supremacisë së Kushtetutës duhet të aplikohet edhe për raportet e parlamentit me pushtetet e tjera. Kjo do të thotë, mes të tjerash, se parlamenti, si rregull, nuk ka një pozicion suprem mbi organet e tjera, e as nuk ka një pozitë monopoliste në sistemin e organeve të shtetit. Siç shprehet në një vendim të saj Gjykata Kushtetuese e Polonisë, për të evituar rrezikun e dominimit të gjithëpushtetshëm të shumicës parlamentare, i cili e ka bazën në një kuptim të thjeshtëzuar të udhëheqjes demokratike, është krijuar *një sistem i demokracisë kushtetuese (shih VGJK të Polonisë datë 22.9.2006)*.

Në vështrim të sa më sipër, mendoj se Presidenti dhe Kuvendi, secili kanë rolin e tyre specifik kushtetues në procedurën e emërimit të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese, dhe asnjëri nga këto organe nuk ka rol kryesor apo dytësor. Kështu, sipas kriterëve kushtetues, Presidenti përzgjedh kandidatin dhe e emëron atë si gjyqtar ndërsa Kuvendi, në bazë të të njëjtave kriterë, jep ose jo pëlqimin për emërimin e bërë, duke shqyrtuar edhe meritën e zgjedhjes së bërë nga ana e Presidentit.

Në përfundim, mendoj se shumica e Gjykatës Kushtetuese duhet të kishte pranuar kërkesën e Presidentit të Republikës duke konstatuar se Kuvendi kishte penguar emërimin e gjyqtarëve të kësaj Gjykate dhe të shfuqizonte si jokushtetuese edhe vendimin e kundërshtuar të Kuvendit.

Anëtar: Petrit Pllloçi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 6.8.2012
Doli nga shtypi më 7.8.2012

| | |
|---------------|------------------|
| Tirazhi: 1200 | Formati: 61x86/8 |
|---------------|------------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 40 lekë